

Ekspozitë
Shkupi mirë-
njohës për ndih-
mën Amerikane

Fq.5



EKONOMI

Plasmani,
problem për
bujqësinë e
Maqedonisë

Fq.7



Për mua
flasin
shifrat,
nuk më
interesojnë
kritikat

Fq.19



Koha

www.koha.mk



Do të diskutohet
shkëmbimi i
territoreve

Fq.16

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3424 · e premte, 27 korrik 2018

15°C | 20°C

15 DEN

EDITORIAL

Si duhet
të veprojmë
me islamin
radikal?



E vetmja zgjidhje e problemit të islamizmit radikal do të vijë nga myslimanët e zakonshëm të cilët nuk dëshirojnë të radikalizohen për arsye se ky proces do t'i eliminojë aspektet të cilat janë vet islami. Për pyetjen se 'cili është islami i vërtetë?'

Fq.2

TEKNOLOGJI

Digjitalizimi
po ndryshon
fëmijërinë

Fq.15

GLOBI

Shmanget
"lufta"
Trump-BE

Fq.17

RAJON

Shqipërisë
i shtohet
edhe një ishull

Fq.12-13



HAPET RRUGA PËR REFERENDUMIN

MË 30 SHTATOR

"PËR" APO "KUNDËR"



Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit Shtetëror Zgjedhorë (KSHZ) në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ditë më parë me shumicë votash nga deputetët e shumicës parlamentare si dhe atyre të deputetëve të partive opozitare, janë krijuar kushtet për organizimin e referendumit në afatin e paraparë. Kuvendi i Maqedonisë gjegjësisht kryetari Talat Xhaferi më herët të shtunën me 28 korrik ose më së voni me 30 korrik të hënën do të shpallë datën e mbajtjes së referendumit

Fq.3

Taksa e Kosovës godet çmimet në tregun e Maqedonisë

Qeveria e Kosovës ka shfuqizuar pjesërisht tak-
sën doganore prej 30 për qind për importet e
produkteve bujqësore. Megjithatë, kjo masë do
të aplikohet për shtatë produkte. Eftim Shaklev,
kryetar i Asociacionit të Bujqve në Maqedoni
për Radion Evropa e Lirë thotë se pikërisht këto
produkte bujqësore janë ato që kalben në
tregjet e Maqedonisë, për shkak të mungesës së
plasimit në treg. "Një pjesë të madhe të specave

ve dhe domateve, por edhe rrushit, ne si bujq i
kemi prodhuar duke llogaritur në tregun e Ko-
sovës. Asgjë nuk është bërë, përderisa nuk hiqen
taksat edhe për specat, domatet, rrushin...
kërkojmë që Qeveria jonë të përgjigjet me
kundërmasa". "Rritja e taksave doganore për 30
për qind ka bërë të mos ketë kërkesa dhe përde-
risa nuk ka kërkesë në treg, është e kuptueshme
se çmimet e pemëve dhe perimeve..."

Fq.7



EDITORIAL

DRAMACITETI
I NGJARJEVE

Emin AZEMI

Kjo mund të jetë ndoshta vera më e nxehtë politike në Maqedoni, e cila duhet të përcaktojë disa linja të së ardhmes. Disa ngjarje që duken në sipërfaqë, e që ende nuk i kanë të qarta konturat, sikur rrëfejnë për një dramacitet të brendshëm të temave e problemeve që pritet të jenë jetike për të ardhmen e këtij vendi dhe banorëve të tij.

Problemet e jashtme, të cilat u reflektuan edhe në zhvillimet e brendshme, por edhe në proceset eurointerguese, sigur kanë filluar të dalin në dritën e rrugëzgjdhjeve. Tejkalimi i kontestit rreth emrit me Greqinë, fillimisht dhe, fillimi i negociatave për anëtarësim në NATO, pastaj, do të shënojnë jo vetëm kthesë në zhvillimet e këtushme, por edhe shpresë për të gjithë ata që nuk duan të mbajnë përgjithmonë kokën prapa.

Çdo kusht që do të kërkoj pikërisht tani nga kryeministri Zaev dhe partitë në pushtet ndonjë "kanal kullues" që do të nxirrte jashtë "ujërat e zeza" të këtij shteti, sigurisht do të merr përgjigje të shpejt se këtë mund ta bëjnë përmes referendumit që pritet të mbahet në fund të shtatorit. Edhe pse i afishuar si përcaktim popullor, që duhet ti jipet përgjigje marrëveshjes me Greqinë, shumë kush në Maqedoni, jo pa arsye, kanë parë të ky refendum edhe shanse të tjera për të etabluar një axhendë të brendshme politike, me do linja më të qarta përkufizimi. Por, si duket treni i ngjarjeve po ecën më shpejt se sa sensibilitetet qytetare, prandaj edhe në këtë referendum do të shkojmë me dy pyetje publike që kërkojnë zgjidhje popullore dhe me shumë pyetje të mbyllura, të cilat do të vazhdojnë të preokupojnë shoqërinë, intelektualët, mediat etj.

Shqiptarët nuk kanë ndërtuar ndonjë qëndrim konsistent sa i përket sfidave që hap ky referendum. Përpos opsionit zyrtar politik, pjesa tjetër e shoqërisë ishte shumë pasive dhe kjo mund ta ketë, paradoksalisht, edhe anën e saj të mirë. Nëse nuk mund të krijohet një masë krike që i ndryshon gjërat, atëherë në shprehje vie pasiviteti, i cili edhe si i tillë s'i prish punë askujt. Më së paku politikanëve në pushtet. Këta të fundit madje kanë arsye të ndjehen komod sepse përballë nuk kanë ndonjë opozitë të organizuar e konsoliduar. Si duket kështu do të jetë edhe një kohë.

Edhe njëherë për referendumin. Ai pra është ideuar që t'i hapë rrugë Maqedonisë për tu integruar, fillimisht në NATO, e pastaj, pas disa viteve, edhe në BE. Por, si do që të jetë epilogu, dhe ai gjithësi duhet të jetë pozitiv, shqiptarët nuk duhet të pushojnë së kërkuarri rrugë e alternativa konstruktive për ta konsoliduar veprimin politik institucional dhe mendimin e lirë intelektual e opozitar. Pas këtij referendumi duhet të pasojnë aksione edhe më efikase politike që do ta bënte integrimin e shqiptarëve në shtet më kuptimplotë. Kjo do të mund të arrihej edhe me forma evropiane të organizimit administrativ e territorial, duke bërë rajonizmin e shtetit, përmes qarqeve ku banorë lokalë do të jenë shfrytëzuesit dhe menaxhuesit e drejtpërdrejt të resurseve financiare, natyrore në nivel vendor.

Shqiptarët në të kaluarën ishin viktimë e një farë hutie që krijon vrapin pas çështjeve të ashtuquajtura madhore, duke anashkaluar jetën e njerëzve dhe ekonominë në nivelin lokal. Në të ardhmen kjo do të mund të korrigjohet përmes projekteve që do të kalonin nëpër duart e ekspertëve dhe nëpër elaborate të studiuar konform kërkesave të banorëve vendorë. Por me një kusht: Kompetencat të shtohen në nivelin lokal përmes rajoneve që do të krijohen sipas modeleve evropiane.

Grekët, një mallkim për ne

"Ndjej keqardhje për çdo jetë të humbur në Greqi. Vdekja është e tmerrshme dhe të trishton kudo ku e sheh. Solidariteti njerëzor duhet të qëndrojë përmbi dallimet tona etnike, racore apo ideologjike. Por edhe të thuash se solidarizohemi me grekët, sepse ata janë fqinjët tanë, është pa kuptim. Po të jetë për fqinjësi ata kanë qenë fqinj të këqinj për ne. Na kanë marrë territor, na kanë vrarë, persekutuar, përzënë nga shtëpitë dhe ende nuk i pranojnë krimet e tyre.

Natyrisht, unë arrij të dalloj grekun e thjeshtë nga politikën shoviniste të vendit të tij dhe nuk fajësoj çdo grek tek e tek për to. Prandaj dhe them se solidariteti dhe empatia që i adresohet njeriut si qenie njerëzore nuk duhet të ngatërrohet me nocionet kolektive njësisht etniko-politike si fqinjësia. Po të jetë për fqinjësi grekët kanë qenë historikisht një mallkim për ne", është ky statusi në Facebook i sociologut nga Tirana, Ergys Mërtiri, pas stuhisë që kaploi periferinë e Athinës.

Shtet serb brenda Kosovës – e pamundur

"Njësoj sikur që ndarja e Kosovës është tradhëti kombëtare, ashtu edhe krijimi i një shteti serb brenda shtetit të Kosovës është tradhëti kombëtare!

Kosova nuk ka toka të pushtuara te cilat duhet t'ia kthejë Serbisë! Perkundrazi, Serbia është ajo që duhet t'ia kthejë tokat e pushtuara Kosovës! Poashtu e pamundur është, që pas gjithë kësaj lufte e viktimitizimi shekullor, që serbët e Kosovës ta bëjnë një Republikë serbe brenda shtetit të Kosovës!!! Gjithë shtetasit e Kosovës pavarësisht etnisë që kanë, mund të bëjnë asociacione komunash për ta përparuar, por jo për ta përçarë e shkatërruar shtetin e Kosovës! Jo, një gjë të tillë nuk e lejojnë ligjet e as Kushtetuta e Kosovës! Ndarjen dhe shpartallimin e Kosovës nuk e lejon populli i Kosovës, nuk e lejojnë SHBA e NATO!", ka shkruar veprimtari Ahmet Asani në profilin e tij në Facebook.

Votat pa muskuj nuk të duhen asgjë!

"Aleanca për ardhmërinë e Kosovës deri tash ka dhënë tre kryeministër. Uroj që ta japë edhe të katërtin! PDK dy. LDK vetëm një. Albini po pret tash e sa kohë, tashmë edhe me kollaren nyje në fyt. Politika nuk është veç me ba vota e me shitë broçkulla në parlament. Politika është në radhë të parë me udhëheqë me shtetin.

Thoni Albinit le ta çlirojë kollaren pak e le të fillojë të forcojë muskujt si Ramushi. N'Kosovë asgjë nuk bëhet pa muskuj! As pushteti, as paraja, as miqësia. Kur është puna për pushtet, muskujt janë më të rëndësishëm edhe se paraja. Krahasoni Ramush Haradinajn me Behxhet Pacollin! Votat pa muskuj nuk të duhen asgjë. Ato janë vetëm numra!

Urime dhe sukses AAK!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, Liri Loshi.

MEDIACitate

"Kjo është vija e kuqe për Kosovën në dialogun me Serbinë"

Teksa ka folur rreth dialogut, ish-kryenegociatorja e bisedimeve Kosovë-Serbi, Edita Tahiri, ka thënë se vija e kuqe për Kosovën (që të mos diskutohet me Serbinë për sovranitetin e Kosovës), kishte ekzistuar prej se kishte filluar procesi i negociatave.

"Dialogu i Brukselit midis Kosovës dhe Serbisë është një dialog i cili është ndërtuar mbi vijat e kuqe që shteti i Kosovës i ka pasur që nga viti 2011, kur ka filluar ky dialog dhe vija e kuqe kryesore ka qenë se në këtë dialog nuk bisedohet për statusin, nuk bisedohet për sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës dhe kjo vijë e kuqe ka vazhduar dhe duhet të vazhdojë edhe në fazën finale të dialogut".

Duke komentuar deklaratat për shkëmbim të territoreve me Serbinë apo ndarje të Kosovës, Tahiri ka vlerësuar se askush nuk mund të flasë për gjëra që e cenojnë integritetin dhe sovranitetin e Kosovës.

"Gjykata ndërkombëtare për drejtësi e ka konfirmuar se pavarësia e Kosovës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Prandaj, mendoj se askush në Kosovë në asnjë rrethanë nuk mund të dalë jashtë kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të flasë për gjëra që cenojnë integritetin dhe sovranitetin territorial të Kosovës", ka shtuar ajo.

I detë e tilla sipas saj, janë tejet të dëmshme dhe i shkojnë në favor vetëm shtetit të Serbisë.

"Serbia gjithmonë ka ëndërruar veriun e Kosovës, për shkak se është i pasur me miniera dhe me ujë. Kjo ka qenë arsyeja pse Kosova ka qenë 100 vjet e okupuar nga Serbia", ka theksuar ajo.

Tahiri tutje ka konsideruar se pa u arritur një dakordim i gjerë mes partive, faza finale e dialogut nuk do të duhej të vazhdonte fare.

"E para, është me rëndësi që pa u arritur një konsensus i gjerë politik dhe kombëtar nuk duhet të shkohet në dialogun në fazën finale, kur të arrihet ai konsensus duhet të fillohet me fazën finale. E dyta, është me rëndësi që vijat e kuqe të jenë të vendosura dhe vija e parë duhet të jetë që Kosova është shtet sovran dhe i pavarur, integriteti territorial është i pacenueshëm", ka theksuar ajo.

(LEXO, 26 korrik)


NËSE NUK
E KENI DITUR...GOMARI DHE ELEFANTI SIMBOLETË
DEMOKRATËVE DHE REPUBLIKANËVE

Gomari njihet si simbol i partise demokratike dhe elefanti perfaqëson partine republikane. Si ka ndodhur kjo?

Mendohet se shënja e elefantit Republikan është përdorur për herë të parë nga një gazetë e Illinois gjatë kohës së zgjedhjeve për president të Abraham Linkoln, (1860), si simbol i forcës. U përhap shumë pasi republikani Thomas Nast

skicoi figurën e elefantit në një revistë të kohës në 1874.

Sa për shenjën e gomarit si simbol i partisë demokratike mendohet se është përdorur për herë të parë gjatë fushatës elektorale për president për Andriu Xhekson (1828) pasi kandidati Xhekson filloi ta përdorte atë në postimet e tij. U përhap shumë në fund të shek. 19.



HAPET RRUGA PËR REFERENDUMIN

MË 30 SHTATOR QYTETARËT DO TË VOTOJNË “PËR” APO “KUNDËR”

Zgjidhja e mundshme sipas kryeministrit për formulimin e pyetjes do të ishte: “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranimin e marrëveshjes me Greqinë për emrin”

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 26 korrik - Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit Shtetëror Zgjedhorë (KSHZ) në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ditë më parë me shumicë votash nga deputetët e shumicës parlamentare si dhe atyre të deputetëve të partive opozitare, janë krijuar kushtet për organizimin e referendumit në afatin e paraparë. Kuvendi i Maqedonisë gjegjësisht kryetari Talat Xhaferi më herët të shtunën me 28 korrik ose më së voni me 30 korrik të hënën do të shpallë datën e mbajtjes së referendumit. Menjëherë pas votimi kryeparlamentari Xhaferi paralajmëroi se në të ardhmen pas çdo marrëveshje që do të arrihet midis liderëve politik, me urgjencë të informohet Parlamenti që të mundet në kohë të caktohen seancat parlamentare.

“Është mirë që në të ardhmen



pas çdo marrëveshje që do të arrihet midis liderëve të partive politike, me shkrim të informohet parlamenti që të mundet në kohë të caktohet seancë parlamentare. Megjithatë nëse ka nevojë për çështje të rëndësishme, siç është mbajtja e referendumit, Kuvendi do të punoj edhe ditën edhe natën që të mundet në afatin e paraparë të shpallë datën për mbajtjen e referendumit”, deklaroi Talat Xhaferi, kryetar i Parlamentit të Maqedonisë.

Ndërkohë kryeministri Zoran Zaev pas formimit të KSHZ-së beson se deri më 30 korrik Kuvendi i Maqedonisë do të sjell vendim për shpalljen e datës së mbajtjes së referendumit dhe i njëjti do të organizohet edhe pa VMRO-DPMNE-në,

në rast se nuk arrihet marrëveshje me liderin e kësaj partie. “Takim të ri liderësh nuk do të ketë, kurse lideri i VMRO-së duhet publikisht të tregojë qëndrimin e tij dhe të partisë, nëse janë për bojkot, për dalje në referendum dhe votim kundër, ose për mbështetje të referendumit”, tha Zaevi. Zgjidhja e mundshme sipas kryeministrit për formulimin e pyetjes do të ishte: “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranimin e marrëveshjes me Greqinë për emrin”.

Kryeministri Zaev edhe njëherë apeloj deri te partia opozitare ta përkrah referendumin që ky proces të jetë i suksesshëm dhe lideri i opozitës Mickovski të mos ushtrojë presion por të gjithë qytetarët të dalin dhe të votojnë sipas bindjes dhe

vullnetit të tyre të lirë se janë “për” apo “kundër” referendumit.

“T’uaa mundësojmë këtë të drejtë qytetarëve të votojnë lirshëm që referendumit të jetë i suksesshëm, nëse unë votoj “Për” kurse Hristijan Mickovski voton “Kundër”, vota ime “për” duhet të këtë vlerë njëjtë si dhe vota e Mickovskit “kundër”, thotë Zaev.

Ndërkohë analisti politik Alajdin Demiri shprehet se VMRO-DPMNE nuk ka asnjë arsye tjetër që të kundërshtoj mbajtjen e referendumit përveç insistimit të amnistojë ish funksionarët e partisë së vet nga veprat e kryera kriminale.

“Mendoj se më në fund do të mbizotëron vetëdija e Mickovskit dhe me siguri referendumit do të jetë i suksesshëm. Fundi i fundit tani më shumica e bashkëpartiakëve të liderit të VMRO-së e kanë të qartë se insistimi i tij për të arritur marrëveshje për amnisti është e pamundshme për shkak se Zaevi në asnjë mënyrë nuk pranon këtë iniciativë, atëherë Mickovski do të heq dorë sepse partia VMRO-DPMNE nuk guxon të mos e përkrah mbajtjen e referendumit”, thotë Alajdin Demiri analist politik. Sipas tij është shumë me rëndësi që procesi të zhvillohet në mënyrë transparent nëse do të merreshin veshë dhe në këtë mënyrë do të merrej argumenti i vetëm partisë opozitare që mos e bojkotojnë referendumin.

KRYEMINISTRI ZORAN ZAEV PËRBALLË DEPUTETËVE



Gjyqësori ta ndryshoi qasjen ndaj korrupsionit

Shkup, 26 korrik - Lufta kundër korrupsionit është prioritet i kësaj Qeveria dhe dispozitat ligjore duhet dhe do të vlejnjë për gjithë.

Megjithatë, edhe gjyqësorit duhet ta ndryshoi mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit. Kështu kryeministri Zoran Zaev, i është përgjigjur deputetit të VMRO-DPMNE-së, Vlatko Gjorçev.

“Arsyeja e vetme që ndikon në trendin negativ në luftën kundër korrupsionit është kriza politike që zgjatë tepër dhe për këtë arsye indeksi i korrupsionit është ashtu siç është. Ligji do të vlejnjë për të gjithë. Megjithatë, gjyqësori gjithsesi se duhet ta ndryshoj qasjen e tij. Me aktivitet e tyre të përditshme ato duhet të dërgojnë porosi se ligjet do të vlejnjë për të gjithë. Askush nuk guxon të mbetet jashtë ligjit në sferën e korrupsionit. Apeloj deri te mediat që na kritikojnë ta mbulojnë këtë pjesë dhe opinionin të jetë i përkushtuar në luftën kundër korrupsionit”, tha kryeministri Zaev, në pyetjen se vallë Qeveria mendon të bëjë diçka drejtë luftimit të korrupsionit. Kryeministri Zaev, në seancën parlamentare për pyetje të deputetëve foli edhe për veprën penale të cilën e ka kryer kryetari i Komunës së Novo Sellës. Ai po ashtu foli edhe për angazhimin e avokatit Vane Andreev, në rastin e kryetari të Novo Sellës, Boro Stojčev, me çka shtoi se avokati Andreev është avokat privat dhe mund të përfaqësoi çdo klient që i drejtohet atij për ndihmë. “Dënimi me burg për këtë veprë, për 35 mijë euro, është nga gjashtë e deri në tre vite heqje lire. Gjashtë muaj është praktikë gjyqësor apo dënim me kusht. Kryetari i Novo Sellës është mik im personal, atë e kam mbështetur në fushatë. Por, çdo njëri që e ka shkelur ligjin duhet të përgjigjet. Vendimi nuk është me pushkatim, por me burg. Çdonjëri duhet të përgjigjet si shembull. Vetëm në këtë mënyrë do ta zvogëlojmë korrupsionin në shtet. Ne duhet të formojmë shtet të këndshëm, në të cilin të rinjtë do të vendosin të qëndrojnë”, tha Zaevi. Mes tjerash ai deputetit Gjorçev i tha se e kupton dhe e mbështet luftën e tij personale.

AGJENCIA E MEDIAVE: VENDIMET PËR NDRYSHIMET E KODIT ZGJEDHOR, SKANDALOZE

Agjencia për shërbime mediale audio dhe audiovizuale i dënon ndryshimet e miratuara në Kodin zgjedhor të sjella ditën e djeshme, me të cilat marketingu i paguar politik gjatë proceseve politike që deri më tani pjesëmarrësit në zgjedhje ua paguajnë mediale nga llogaritë e tyre, do të paguhet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, përmes Ministrisë së Financave.

Ndryshimet e Kodit zgjedhor u sollën me procedurë të shkurtuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa pas marrëveshjes paraprake në takimin e liderëve të partive politike.

Nga ASHMAA theksojnë se shpenzimet për marketing të paguar politik dhe vëllimi i tyre nëpër media deri më tani ishin të kufizuar nga mundësitë financiare të subjekteve politike, ndërsa zgjidhja



e mundëson që ato të rriten sepse do të paguhet nga paratë e qytetarëve.

Në praktikën evropiane, thuhet në kumtesën e ASHMAA, ekzistojnë raste të izoluar për kompensimin e shpenzimeve të mediale nga buxhetet shtetërore gjatë zgjedhjeve, por për mediat të cilave u imponohen obligime për prezantim falas politik të pjesëmarrë-

sve në zgjedhje, në kushte kur është i ndaluar marketingu i paguar politik, që ky nuk është rast në Republikën e Maqedonisë.

Sipas ASHMAA, dispozita e re për limite shtesë për marketing të paguar politik në radio dhe televizion, sërish nuk siguron kushte të barabarta për qasje deri tek marketingu i paguar politik për të gjithë pjesëmarrësit e pushtetit dhe nga

opozita parlamentare dhe aspak nuk parasheh kohë për marketing për kandidatët e pavarur.

Përzjerja në lirinë editoriale të mediale është zgjidhje ligjore me të cilën pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore do t'i përgatisin mediat për marketing të paguar politik, në vend të mediale, thuhet në kumtesën e ASHMAA.

Nga ASHMAA reagojnë se në vend që të fshihet obligimi për ndërhyrje të prezantimit mediatic në internet portalet pas indikacioneve dyvjeçare nga Agjencia për shërbime mediale audio dhe audiovizuale, Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë, sektorit civil dhe opinionit profesional, sepse është në kundërshtim me standardet evropiane, me obligimet e ndryshuara për mbikëqyrjen e portaleve dhe imponohen tek Komisioni Shtetëror Zgjedhor./MIA/

LAJME SHKURT

Partitë do të marrin 5 milionë euro prej buxhetit shtetëror

Shkup, 26 korrik - Ligji i ri për financimin e partive politike që kaloi dje në Kuvendin e Maqedonisë do t'ju mundësojë partive që të marrin shumë të parave në vlerë prej 2.5 për qind më të larta se e deritashmja.

"Shuma totale për financim vjetor të partive politike janë në lartësi prej 0.06 për qind nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë", thuhet në ligj.

Në ligjin e ri, përqindja 0.06 është rritur në 0.15.

Kështu, në bazë të përlogaritjeve, nëse me buxhetin e vitit 2018 i cili ishte 3.4 miliardë euro, për partitë politike kanë shkuar rreth 2 milionë euro. Me ligjin e ri kjo vlerë do të arrijë deri mbi 5 milionë euro.

Millososki nuk mund të posedojë dokumente sekrete

Shkup, 26 korrik - Përmes një deklarate ka reaguar zyra e Kryetarit të Kuvendit që dokumentet e klasifikuara, të marra nga dikush dhe nga çdo organ, nuk mund të posedojnë persona pa certifikatë të sigurisë. "Kryetari i Komitetit për Politikë të Jashtme, Antonio Millososki, nuk ka certifikatë sigurie për më shumë se një vit, edhe pse iu është theksuar nga shërbimet e ekspertëve në Kuvend se i ka skaduar asaj të më hershmes. Sipas kësaj, deputeti dhe kryetari i Komisionit, në pajtim me Ligjin për Informacione të Klasifikuara, i cili nuk është i pajisur me certifikatën e nevojshme të sigurisë, nuk mund të kërkojë, të posedojë dhe publikojë dokumente publike që kanë një përcaktim "konfidencial", thuhet nga zyra e Xhaferit. Nga zyra e kryetarit shtuan se Millososki i paraqiti zyrës së Ivanovit një kërkesë për marrjen e materialeve nga takimi i liderëve të mbajtura në janar dhe maj të këtij viti, ndërsa në një mënyrë të palejuar dhe në rrugë ilegale, personalisht, jo përmes arkivit, ai mori materialet nga zyra e kryetarit, diçka që nuk është sipas ligjit.

Kryetari i Novo Sellës dënohet me 18 muaj burg

Shkup, 26 korrik - Gjykatata e Strumicës sot ka shqiptuar vendimet për kryetarin e Novo Sellës, Boro Stojčev dhe njerëzit të cilët u kapën në lokalitetin rreth Popova më 10 korrik për transportimin e cigareve. Nga gjykata njoftuan se kryetari i komunës Stojčev u dënua me burgim prej një viti e gjashtë muaj derisa djali dhe nipi i tij u dënuan me një vit burgim. Të gjithë të akuzuarit i kanë pranuar veprat penale me çka kanë të drejtë të ankohen deri tek Gjykata e Apelit në Shtip. Sipas akt-gjykimit shfuqizohet edhe masa e paraburgimit për të cilën prokuroria ka të drejtën e ankimit. Kryetari i Novo Sellës me të afërmit e tij ishte kapur dy kilometra afër vendkalimit kufitar në mes Maqedonisë dhe Bullgarisë, ku nëpërmjet dy veturave kontrabandonte 33 mijë kuti cigaresh nga marka Kalipso në shumën e një milion e 200 mijë denarë.

Portal për të dhëna të hapura

Shkup, 26 korrik - Ministri i Shoqërisë Informatike, Damjan Maņevski në konferencën e shtypit ka paralajmëruar se është në fazën përfundimtare punimi për hapjen e një portali për të dhëna të hapura, ku ai theksoi se në këtë mënyrë do t'ju ofrohen qytetarëve e jo qytetarët t'i kërkojnë ato. Emri i këtij portali do të jetë Data.gov.mk "Detyra jonë kryesore është t'i sjellim shërbimet te qytetarët, kjo është shumë më e lehtë sesa t'i sjellim qytetarët te shërbimet. Hapja e të dhënave është vetëm një nga mekanizmat se si mund ta arrijmë këtë. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për momentin punon për portalin e ri për të dhëna të hapura që është në fazën përfundimtare. Qëllimi është që në mënyrë më të lehtë dhe vizuale të afrohen të dhënat e hapura te qytetarët. Duhet të potencoj se bëhet fjalë për meta të dhëna që do të vihen në funksion dhe do të shfrytëzohen", tha në konferencë për media ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Maņevski.

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM ME NORVEGJINË

Zëvendëskryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për Çështje Evropiane, Bujar Osmani dhe Ambasadori i Mbretërisë së Norvegjisë sot në hapësirat e Sekretariatit për Çështje Evropiane, nënshkruan Memorandum për mirëkuptim dhe bashkëpunim projektues bilateral

Para fillimit të ceremonisë së nënshkrimit të Memorandumit për mirëkuptim, Zëvendëskryeministri Osmani dhe Ambasadori Bjornstad, mbajtën takim ku diskutuan për bashkëpunim bilateral, mbështetjen projektuese të cilën Mbretëria e Norvegjisë ia siguron Republikës së Maqedonisë, si dhe për aspiratat euroatlantike të vendit tonë.

"Edhe pse Mbretëria e Holandës nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, është partneri ynë i rëndësi-



shëm dhe mbështetës i procesit euro-integrues të Republikës së Maqedonisë nga vetë fillimi i procesit, dhe jam i kënaqur se në këtë bashkëpunim ynë vazhdon të lëviz edhe në këto momente kyçe për Republikën e Maqedonisë"- theksoi Osmani.

Në vazhdim të takimit Zëvendëskryeministri Osmani shtoi se Bashkëpunimi zhvillimor nuk paraqet vetëm instrument për avancimin dhe mbështetjen e synimeve zhvillimore të vendit dhe përcaktimeve tona strategjike, por edhe mundësi

për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve po ashtu edhe në aspektin ekonomik dhe politik.

Në kontekst të nënshkrimit të Memorandumit për mirëkuptim Osmani potencoi se qëllimi kryesor do të jetë mbështetje për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, si dhe mbështetje e prioritetëve të Qeverisë përmes financimit të projekteve që kontribuojnë për proceset reformuese dhe zhvillimin e sektorëve në përputhje me standardet e BE-së dhe të NATO-s.

Nikolla Dimitrovi sërish u pengua të jep raportin

Shkup, 26 korrik - Partia opozitare VMRO-DPMNE për të dytën ditë me radhë ka penguar Ministrin e Jashtëm, Nikolla Dimitrov që të japë raportin për realizimin e politikës se jashtme në Komisionin parlamentar për Politikë të Jashtme. Kreu i komisionit nga radhët e

VMRO-së, Antonio Millososki dhe bashkë-partiakët e tij janë decid se para se t'i jepet fjala Dimitrovit, deputetët duhet të kenë qasje në dy dokumente të klasifikuara që kanë të bëjnë me takimet e liderëve në janar dhe maj të këtij viti. Për shumicën parlamentare këto

kërkesa paraqesin vepra të rënda penale dhe dëmtojnë interesat shtetërore. Ndërkaq Dimitrov tha se është jokorrekte të shfaqen shënime nga takimi i janarit, përdërisa në atë takim nuk ka pasur marrëveshje për marrje të shënimeve.

Maņevski kërkoj dorëheqjen e anëtarëve të Këshillit programues të RTVM-së



Shkup, 26 korrik - Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Maņevski sot sërish u bëri thirrje anëtarëve të Këshillit programues të RTVM-së të japin dorëheqje. "Për mua është me të vërtetë e çuditshme që anëtarët e Këshillit programues të RTVM-së në asnjë mënyrë nuk u përgjigjën në thirrjen time të japin dorëheqje. Një servis i

pavarur publik në ndonjë mënyrë do të përgjigjej në thirrjen të japin dorëheqje për shkak të pozitës katastrofale në të cilën e sollën RTVM-në. Heshnja nga ana e tyre tregon gjithçka. Edhe njëherë u bëj thirrje të japin dorëheqje që të mund të zbatohen reformat mediale", tha Maņevski, duke i'u përgjigjur pyetjes së gazetarëve pas konfe-

rencës së sotme për shtyp në Qeveri.

Vetëm ashtu, konsideron ai, zhbllokohet edhe sjellja e ndryshimeve të Ligjit për shërbime mediale audio dhe audiovizuale. "Pengesja e vetme dhe arsye për shkak të së cilës VMRO-DPMNE e bllokoi sjelljen e ligjit është t'i mbajnë njerëzit e tyre në këshillin programues të RTVM-së", pohoi ministri. Plan "B" për dalje nga kjo situatë, sipas ministrit, ka.

"Nëse ka nevojë do ta shpallim. Ndoshta nuk do të ketë nevojë për atë", tha Maņevski, sipas të cilit biseda për këtë temë tani nuk ka, por disa amendamente të propozuara nga opozita për Qeverinë janë të pranueshme. Sipas tij, pengesa kryesore është insistimi i VMRO-DPMNE-së opozitare anëtarët e këshillit programues të RTVM-së të mbesin deri në fund të mandatit dhe të Këshillit të Agjencisë për shërbime mediale audio dhe audiovizuale.

Materiali i publikuar në ekspozitën dokumentare të ITSHKSH-së, nxori në pah një detaj shumë interesant. Hulumtimi i realizuar nga ekipi i këtij Instituti për shënimin e 55 vjetori të tërmetit katastrofal të vitit 1963 që e kishte goditur Shkupin, ka konstatuar se qumështin në pluhur përherë të parë shkupjanet e kishin shijuar pas arritjes së ndihmave Amerikane ne qytet. Drejtori Asani, theksoi se banorët e Shkupit më pas këtë ushqim e kishin emërtuar ndryshe si "Qumështi Amerikan"

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 26 korrik - Në mesin e 78 shteteve që e kishin ndihmuar rimëkëmbjen e Shkupit, pas 26 korrikut të vitit 1963, zë vend edhe Amerika e largët. Përmes ekspozimit të dokumenteve dhe fotografive ekskluzive nga ndihmat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dërguar banorëve të Shkupit, 55 vite më parë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, (ITSHKSH) të enjten e shënoi përvjetorin e tërmetit katastrofal që e kishte goditur Shkupin. Kryetari i ITSHKSH-së, Skender Asani, në fjalimin e tij tha se shumë shtet botërore edhe pas 55 vite mund ti gjejnë gjurmët e vetë të humanizmit në Shkup.

"Dridhjet e forta që e kishin goditur Shkupin, kishin ndikuar që mbi 80 për qind e qytetit atëkohë të rrënohej. Mirëpo, në çastet e dhimbjes dhe rënies gjithmonë qëndron një dorë e solidaritetit për të na dëshmuar se nuk jemi të vetmuar dhe të braktisë. Përderisa shkupjanet dhe Shkupi e vajtonin atë të cilën e kishin humbur nga tërmetit, u ngrit pjesa më e madhe e botës për të dëshmuar humanizmin dhe solidaritetin e tyre në vepër. Deri atëherë shkupjanet kishin pasur hamendje se vallë Bota ka njohur për ekzistencën e tyre, megjithatë vera e vitit 1963 dhe viteve më pas ishte dëshmi se Bota kishte respekt të veçantë për këtë qytet dhe banorët e tij. Kështu që tragjedia e Shkupit i bashkoi edhe shtetet kundërshtarë të cilat njiheshin si udhëheqës të Luftës së Ftohtë. Por, pa dyshim ndihmat më të madhe që kishin arritur ditët e para pas tërmetit ishin ato nga kontingjenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës", tha drejtori Asani.

Materiali i publikuar në ekspozitën

EKSPOZITË DOKUMENTARE E ITSHKSH

SHKUPI MIRËNJOHËS PËR NDIHMËN AMERIKANE



zitën dokumentuese të ITSHKSH-së, nxori në pah një detaj shumë interesant. Hulumtimi i realizuar nga ekipi i këtij Instituti për shënimin e 55 vjetori të tërmetit katastrofal të vitit 1963 që e kishte goditur Shkupin, ka konstatuar se qumështin në pluhur përherë të parë shkupjanet e kishin shijuar pas arritjes së ndihmave Amerikane ne qytet. Drejtori Asani, theksoi se banorët e Shkupit më pas këtë ushqim e kishin emërtuar ndryshe si "Qumështi Amerikan."

Përveç e ndihmave ushqimore, shkupjanet nga Amerika, sipas të dhënave nga Arkivi i Qytetit të Shkupit, kishin pranuar edhe ndihma mjekësore, pajisje për ndërtim e vegla të ndryshme për rindërtimin e shtëpive të tyre.

"Vlen të theksohet shteti Amerikan, në krye me kryetarin Xhon Kenedi, e kishin dëshmuar në ve-

pra proverbin se 'Miku i mirë shihet në ditë të vështira'. Përtej Atlantikut ato erdhën edhe kontribuon në ngritjen e Shkupit. Ndihma e SHBA-ve, nuk mungoi edhe së fundmi kur Shkupi si një qendër politike e Maqedonisë ishte në udhëkryqin historik rreth përpjekjeve për anëtarësim në NATO dhe BE. Mbështetja e Ame-

rikanëve drejtë perspektivës, stabilitetit dhe mirëqenies ishte evidente. Përmes kësaj ekspozite në emër të Shkupit dhe shkupjanëve ne dëshirojmë ta falënderojmë shtetin Amerikan për ndihmën e vazhdueshme që e ka dhënë në të kaluarën dhe mbështetjen e proceseve euro atlantike që janë aktuale", tha Asani.

Ministri i Arsimit, Arbër Ademi, i cili nga afër e përcolli ekspozitën e titulluar "55 vjet nga ndihma Amerikane për Shkupit", shprehur mirënjohje për të gjitha shtetet që e kanë ndihmuar rindërtimin e Shkupit, pas tërmetit të vitit 1963. Me theks të veçantë ai u ndalë në angazhimin e SHBA-ve për ofrimin e ndihmës që ata ia dhanë shkupjanëve, 55 vite më parë.

"Pas dy tërmeteve të mëhershme ai i vitit 1518 dhe ai i vitit 1555, Shkupi edhe ne vitin 1963 pësoi një katastrofë natyrore. Por dora e zgjatura e miqve nga i gjithë globi sadopak e zbuti dhimbjen fizike dhe materiale. Krahas shumë shteteve të botës, SHBA-të ishin shtete e parë që u vunë në ballë të karvanit të ndihmave që u nisën drejtë Shkupit. Aksionet humanitare të realizuar nga populli solidar Amerikan ishin të jashtëzakonshme. Për kontributin e tyre më së miri flet kjo ekspozitë dokumentuese", tha ministri Ademi.

Ambasadën e SHBA-ve në Shkup, në këtë ekspozitë e përfaqësoi Oficeri për marrëdhënie me publikun, Benjamin Lingman, i cili shtoi se shteti i tij ishte vetëm pjesë e shumë shteteve që e ndihmuan ringritjen e Shkupit.

"Forcat ajrore të SHBA-ve në Shkup kishin arritur vetëm tre ditë pas tërmetit. Ndihma e para që kishin arritur ishin tendat dhe shtrëtorë për të sëmurë. Më pas mbi 20 aeroplan të mbushur me ndihma të ndryshme ateruan në Shkup. Shteti ynë disponon me një histori të gjatë të ofrimit të ndihmave pas ndodhjes së tragjedive natyrore. Zbulimet e ITSHKSH-së dhe drejtorit Skender Asani e vërtetojnë lidhjen e fortë miqësore që SHBA-të dhe banorët e këtyre trevave e kanë ndër vite. Gjithsesi kjo miqësi do të vazhdojë të kultivohet edhe më tej", tha Lingman.

SHKUPI U ZGJUA ME TINGUJT E SIRENAVE

Qytetarët e Shkupit i të enjten në orën 5:17 i zgjuan tingujt e sirenavë në shenjë përkuajtimit të tërmetit katastrofal më 26 korrik të vitit 1963. Një grup artistësh urbanë nga Qendra për arte bashkëkohore e realizuan audio aksionin "Zgjuhu Shkupi" saktë në orën 5:17 minuta në pesë lokacione të ndryshme nëpër qytet dhe i përkuajtuan qytetarët e Shkupit për kohën e saktë të ngjarjes tragjike. "Me këtë audio aksion, artistët urbanë dhanë kontributin e tyre origjinal duke i nderuar viktimat nga tërmeti dhe vendosën dimension të ri në shënimin e kësaj

tragjedie në Shkup", kumtoi Qyteti i Shkupit. Sipas grupit të aktorëve urbanë, me hyrjen e tingujve të sirenavë në çdo shtëpi të qytetarëve të Shkupit dhe zgjimin e banorëve në orën 5:17 në mënyrën më të mirë të mundshme çdo banori të Shkupit do t'i mbetet kujtesa e tërmetit, kujtimet e trishtatë tragjedisë të cilat me kalimin e kohës nuk do të zbehen nga gjenerata në gjeneratë. Konsiderojnë se çdonjëri i cili do t'i dëgjojë tingujt e sirenavë do të kujtojë katastrofën e vitit 1963 dhe në kujtesën e tij do të mbetet data 26 korrik.

Kjo stërvitje paraqet moment të veçantë që do të konfirmojë kapacitetin dhe aftësinë e ARM-së që të jetë nikoqire në më shumë stërvitje në të ardhmen duke përfshirë edhe ushtrimet nën udhëheqjen e Maqedonisë—“Goditja vendimtare” në 2019 ku do të marrin pjesë rreth 1000 ushtarë nga forcat ushtarake të SHBA-së për Evropën dhe nga ARM

Shkup, 26 korrik- Njësi të përzgjedhura nën udhëheqjen e Komandës Evropiane të Forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) do të stërviten në poligonin ushtarak Krivolak në Maqedoni nga data 1 deri më 20 gusht 2018, nën ndihmën dhe mbikëqyrjen nga Armata e Republikës së Maqedonisë. Ushtarët nga SHBA do të fillojnë të vijnë në Maqedoni që nga dita e nesërme.

Në këto njëzet ditë stërvitje do të marrin pjesë njësi të forcave ushtarake të SHBA-së për Evropën, ndërkaq me datën 15 gusht do të jetë dita e hapur në Krivolak ku do të zhvillohen aktivitete të ndryshme të organizuara nga ushtria e SHBA-së me ndihmën e Republikës së Maqedonisë.

Kjo stërvitje paraqet mundësi dhe aftësi të mirë për Armatën e Republikës së Maqedonisë (ARM) që të jetë nikoqire për stërvitjet në Krivolak, me çka do të jetë hera e parë që njësitë e aviacionit të SHBA-së do të përdorin poligon në

USHTARËT AMERIKANË BASHKË ME ARM NË KRIVOLLAK

STËRVITJE ME PËRFITIME EDHE EKONOMIKE



Maqedoni. ARM do të sigurojë mbështetje logjistike, vendbanim, ndihmë dhe shoqëri gjatë udhëtimit si dhe do të vëzhgoj aktivitetet e tyre.

Të pranishëm në brifingun e sotëm informativ rreth trajnimit të anëtarëve të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara në Evropë, ish-inferieri i ARM-së nga SHBA, Kris Micel, komandanti i këtyre stërvitjeve Nik Dukiç si dhe Atanas Spanovski, inferieri i stërvitjeve në ARM.

Kjo stërvitje paraqet moment të veçantë që do të konfirmojë kapacitetin dhe aftësinë e ARM-së që të jetë nikoqire në më shumë stërvitje në të ardhmen duke përfshirë edhe ushtrimet nën udhëheqjen e Maqedonisë—“Goditja vendimtare” në 2019 ku do të marrin pjesë rreth 1000 ushtarë nga forcat ushtarake të SHBA-së për Evropën dhe nga ARM, deklaroi Micel. Ai theksoi katër qëllimet kryesore në Krivolak, ku si më të rëndësishme e

veçoi, se ky bashkëpunim në mes ushtrisë së Maqedonisë dhe asaj SHBA-së do të kontribuojë për anëtarësimin e Maqedonisë në Aleancën e NATO-s. Për të “Krivolak” është një perlë e papërpunuar e cila duhet të çmohet për shkak pozitës gjeografike që ka, madhësisë e terrenit dhe të gjitha resurseve tjera që posedon.

“Ne do të jemi në kontakt dhe do të punojmë me Qeverinë e Maqedonisë dhe të gjitha institucionet tjera përkatëse për zhvillimin e standardeve të këtij poligoni që të hapim rrugët dhe mundësi të reja”, tha Micel.

Me anë të kësaj stërvitje ne do të përmirësojmë, përforcojmë, avancojmë si dhe do të shkëmbejmë përvojë mes ushtarëve të të dyja shteteve, deklaroi komandanti i ARM-së për stërvitje. Këto ushtrime do të kryhen gjatë ditës dhe natës.

Komandanti Dukiç i cili është i angazhuar për këtë stërvitje theksoi se primare në këtë ngjarje do të jenë ushtrime të forcave të aviacionit, ushtrime individuale për përdorimin e armëve. Më pas këto ushtrime do të kryhen në ekipe, përdorimi i armëve nga kalibri i vogël, armë kundër-tankeve, armë automatike M240H, armë standarde të cilat përdoren në më shumë ushtri të vendeve anëtare në NATO.

Një stërvitje e këtillë e SHBA-së vitin e kaluar është zhvilluar në një vend tjetër të Evropës Juglindore ku kanë marrë pjesë 4-5.000 ushtarë amerikanë që rezultoi me \$3-5 milion dollarë në ekonominë lokale, nëpërmjet kontratave dhe shërbimeve. Nëse poligoni “Krivolak” do të zhvillohet, përfitime të ngjashme ekonomike do të ketë edhe Maqedonia me organizimin e ushtrimeve ushtarake në të ardhmen. (R.B)

BDI: Taravari ndan tri herë mjete financiare për të njëjtin qëllim

Gostivar, 26 korrik - Keqpërdorimet me furnizimet publike në komunën e Gostivarit, tashmë janë bërë praktikë punë e Taravarit. Skandali i radhës është bërë për furnizimet rreth rregullimit hortikulturor të hapësirave të gjelbëra. Për të njëjtin qëllim, tendere janë hapur edhe nga komuna edhe nga Ndërmarrja Publike për Parkingje dhe Gjellërim. Konkretisht, për punët e njëjta Ndërmarrja Publike për Parkingje dhe Gjellërim përmes një kumtese dhe prononcimi publik të drejtorit, më datë 16.03.2018njoftoi që kostoja e projektit është rreth 30 mijë euro, para këto të siguruara nga vetë ndërmarrja. Skandali thellohet kur me datë 2.04.2018, Ndërmarrja Publike për Parkingje dhe Gjellërim hap shpalljen me numër rendor: 03/2018, për furnizim tjetër por për dedikim të njëjtë. Pas gati një muaj nga deklarimi publik i drejtorit i cili potencoi që mjetet rreth investimin ishin të siguruara nga ndërmarrja, hapet sërish shpallje për furnizim publik. Që keqpërdorimet të thellohen dhe të marrin përmasa shqetësuese për interesin publik, komuna e Gostivarit shpall furnizim tjetër publik për investimin e njëjtë. Me datë: 08.06.2018 shpallet furnizimi publik me numër rendor: 06/2018 dhe me vlerë prej 5.000.000,00 denarë, thuhet në reagimin e degës së BDI-së në Gostivar.

Paradoks tjetër paraqet fakti që afatet ligjore për furnizimin publik marrin kohë deri 30 ditë për të përfunduar procedura e furnizimit. Duke pasur para sysh funksionimin e Ndërmarrjes Publike për Parkingje dhe Gjellërim, njera ndërveprimtarit është edhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëra dhe e cila ka kryer tashmë furnizime për të njëjtin punë, përse komuna e Gostivarit ka hapur shpallje për këtë furnizim. A do të mbjellen lule mbi lule në hapësirën e njëjtë? Sipas shpalljeve dhe deklarimeve publike, për rregullimin e një pjese të ngelur të parkut të madh të qytetit, ndahen gati 120 mijë euro. Edhe pse, Ndërmarrja Publike për Parkingje dhe Gjellërim ka program vjetor pune dhe e njëjta është miratuar në Këshillin e Komunës së Gostivarit, për çka, janë ndarë mjete financiare nga komuna, Taravari hap furnizim të ri për punët e njëjta, thuhet në reagimin e degës së BDI-së në Gostivar.

Riemërtohet muzeu i VMRO-së, janë zbuluar parregullsi

Ministri i kulturës Asaf Ademi është përplasur me deputetin e VMRO-DPMNE-së Vllatko Gjoçev pasi ky i fundit i kërkoi të mos ndërhyjë në muzeun e VMRO-së duke thënë se kjo është pasuri e shenjtë për popullin maqedonas. Ai, e ka paralajmëruar ministrin e kulturës, Asaf Ademi, që mos ta prek Muzeun e VMRO-së, pasi që u njoftua se muzeu do të riemërtohet në mënyrë që të hiqet nga emri i tij sepse është në shenjë ndaj viktimave të komunizmit. Gjoçev e ka kërcënuar mini-



strin se do të ketë pasoja dhe përgjegjësi nëse muzeu preket nga ata, i cila tha se, është punë e shenjtë për popullin maqedonas.

Ministri Ademi në përgjigjen e tij tha se muzeu as nuk rrenohet e as nuk dëmtohet, por ka një komision që ka konstatuar se

duhet të riemërtohet dhe ka zbuluar shumë parregullsi në projekt. “Më vjen keq që parashtroni pyetje deri tek ministri i Kulturës shqiptar, e jo vetëm deri tek ministri. Nuk fshihem pas vendimeve, ekziston grup punues për arsyeshmërinë e ekzistimit të këtij muzeu. Muzeu nuk do të mbyllet, por do të riemërtohet. Aty janë konstatuar një sërë parregullsish të cilat i kanë vërtetuar ekspertët. Këtë vendim nuk do ta sjellë ministër shqiptar, por ministër i Kulturës së Maqedonisë”, ka deklaruar Ademi.

PDSH mbajti kuvende zgjedhore në Kumanovë dhe Likovë

Në vazhden e përgatitjeve të kongresit të shtatë të Partisë Demokratike Shqiptare të mërkurën (25.07.2018) u mbajtën kuvende të rregullta të degëve të PDSH-së në Kumanovë dhe Likovë.

Punimet e këtyre kuvendeve i ndoqi kryetari i partisë, z.Menduh Thaçi, si dhe kryetari i këshillit për organizimin e kongresit të partisë, z.Azem Sadiku.

Në kuvendin e degës së Kuma-

novës për kryetar të degës u zgjodh Halil Kurtishi, kurse në Likovë për kryetar u zgjodh Ragmi Isufi. Gjithashtu në këto kuvende u zgjodhën kryesitë e degëve, delegatët e kongresit, si dhe propozimet për anëtarë të kuvendit qendror të Partisë Demokratike Shqiptare. Kryetari i PDSH-së Menduh Thaçi pasi përshëndeti punimet e kuvendeve vlerësoi se janë momente shumë të rëndësishme

për vendi dhe rajonin, si dhe theksoi se procesi Euro-Atlantik është prioritet absolut për Partinë Demokratike Shqiptare dhe shqiptarët e Maqedonisë, andaj në këtë drejtim kërkoi një mobilizim dhe angazhim maksimal të strukturave partiake, duke shtuar se dyert e PDSH-së janë të hapura për të gjithë shqiptarët pa marrë parasysh bindjet e tyre politike./Shërbimi për Informim - PDSH



MUNGON SHITJA E SIGURT

PLASMANI, PROBLEM PËR BUJQËSINË E MAQEDONISË

Vlerësohet se politika bujqësore në shtet duhet të fokusohet në planifikimin, zhvillimin dhe avancimin e mundësive për plasman. Në këtë mënyrë, të hollat e harxhuara buxhetore do të japin më shumë rezultate se pagesa për dëmet e ndryshme



Koha

Fisnik Pasholli

Shkup, 26 korrik—Bujqit në Maqedoni për çdo vit kanë probleme me shitjen e sigurt të prodhimeve bujqësore. Krahas problemit të fundit të shtrenjtimit për 30 për qind, në tregun kosovar të domateve, specave, mollëve, dardhave, kumbullat, apo rrushit të prodhuar në Maqedoni si rrjedhojë e vendosjes së doganave kundër marrëveshjeve për tregti të lirë, ekzistojnë edhe më shumë probleme të tjera për bujqit vendor. Fermerët në shtet ankohen se pak respektohet prodhimitaria e kontraktuar, ndërsa nga njëra anë rriten çmimet prodhuese, ndërsa nga ana tjetër, çmimet shitëse janë të ulëta. Këtë e dëshmojnë edhe problemet me çmimin e ulët të lakrës dhe qengjit, por edhe grurit në vend se paku 12 denarë në vitet e kaluara është

grumbulluara edhe për 7 deri 8 denarë. Gjithashtu edhe prodhuesit e rrushit, domateve, mollëve, por edhe fermerët që prodhojnë qumësht, ankohen me vite për çmime tejet të ulëta të grumbullimit që shpesh nuk justifikojnë as koston e prodhimit.

Nga Federata e Fermerëve të Maqedonisë, thonë se vendimi i Kosovës për rritjen e doganave për më shumë prodhime bujqësore që importohen nga Maqedonia, dëshmoi edhe një herë se një nga problemet më të mëdha të bujqësisë së Maqedonisë, është shitja e sigurt e prodhimeve të ndryshme bujqësore.

“Zbatimi i tanishëm i kësaj mase nga ana e Kosovës do të krijojë pasoja të mëdha negative siç janë humbja në këmbimin tregtar prej disa milion dollar me çmime të zvogëluara të grumbullimit në tregjet vendore, ulje të besimit dhe sigurisë lidhur me sasinë e dorëzuar gjatë grumbullimit, zëvendësi-

min e tregut kosovar me prodhime të tjera, në vend të prodhimeve tradicionale të eksportuara nga Maqedonia në këtë periudhë të vitit etj”, vlerësojnë nga Federata e Fermerëve të Maqedonisë.

Sipas tyre, politika bujqësore në shtet duhet të fokusohet në planifikimin, zhvillimin dhe avancimin e mundësive për plasman. Në këtë mënyrë, të hollat e harxhuara buxhetore do të japin më shumë rezultate se pagesa për dëmet e shkaktuara.

Nga ana tjetër, gati nuk ka vite që bujqit të mos ankohen se në Maqedoni mungon një treg i rregulluar i ofertës dhe kërkesës, pak respektohen marrëveshjet me tregtarët apo grumbulluesit, ndërsa në një pjesë të madhe dominon prodhimitaria bujqësore pa rend dhe pa plan në vend të asaj të planifikuar. Vështirësitë me shitjen e sigurt të prodhimeve bujqësore i mbështet edhe anketa midis 128 ekonomistëve bujqësorë në tërë vendin e

organizuar nga Koalicioni rural, që tregoi se problemi më i madh për bujqit në vendbanimet rurale paraqet plasmani i prodhimitarisë dhe grumbullimi jo i organizuar, që si rrjedhojë ka edhe çmimet më të ulëta të prodhimeve bujqësore.

Në ndërkohë, edhe agronomët theksojnë se nëse dëshirojmë të kemi bujqësi bashkëkohore, konkurruese, dhe të orientuar ndaj eksportit për shkak se Maqedonia si treg është tejet i vogël, nevojitet që bujqit të organizojnë punën e tyre në kooperativa, me qëllim që të arrihet një drejtpeshim më i madh midis investimit të punës dhe të të hollave dhe kthimit të tyre në emër të profitit. Në Maqedoni, punojnë vetëm 38 kooperativa dhe përmes tyre në treg plasohen vetëm 9 për qind e prodhimitarisë bujqësore, përkundër praktikave perëndimore ku pjesa dërmuese e shitjes së prodhimeve bujqësore realizohet përmes kooperativave.

“I vetmi shpëtim për bujqit

është të organizohen në kooperativa ku mund të punësohet ndonjë profesionist që do të ndjek tregun dhe prodhimtarinë, do të kryejë hulumtime, si dhe do të këshillojë fermerët se si dhe çka të prodhojnë. Fermerët nuk mund të merren me bujqësi duke shitur prodhimet e tyre në mënyrë individuale për shkak se një praktikë e tillë nuk ekziston askund në botë, por vetëm të bashkuar mund të ofrojnë prodhim konkurrues në treg”, thotë eksperti bujqësor Boris Anakiev.

Gjithashtu, bashkimi në kooperativa mbetet e vetmja perspektivë e bujqësisë në Maqedoni që dallohet me parcela të shpërndara dhe të imëta që nuk mund të prodhojnë sasi më të mëdha të prodhimeve cilësore dhe konkurruese të prodhimeve bujqësore që do të shiten në tregjet e rajonit dhe ato evropiane.

Sipas agronomëve, është me interes për bujqësinë e Maqedonisë të bëhet orientimi i prodhimit sipas predispozitave që kanë regjionet e caktuara për prodhimin e kulturave lavërtare, perimore, pemëtare, dhe blegtorisë. Kërkohej edhe bëhet planifikimi i prodhimit sipas trendeve të zhvillimit të tregut për të mënjeluar mundësinë e paraqitjes së hiper-prodhimit të një kulture të caktuar bujqësore dhe deficitin e një kulture tjetër në treg, që si pasojë sjell çrregullimin dhe disbalansin e çmimeve të atij produkti, ku një vit është i papërbalueshëm për konsumatorin dhe vitin tjetër për prodhuesin.

TAKSA E KOSOVËS GODET ÇMIMET NË TREGUN E MAQEDONISË

Qeveria e Kosovës ka shfuqizuar pjesërisht taksën doganore prej 30 për qind për importet e produkteve bujqësore. Megjithatë, kjo masë do të aplikohet për shtatë produkte. Eftim Shaklev, kryetar i Asociacionit të Bujqve në Maqedoni për Radion Evropa e Lirë thotë se pikërisht këto produkte bujqësore janë ato që kalben në tregjet e Maqedonisë, për shkak të mungesës së plasimit në treg.

“Një pjesë të madhe të specave dhe domateve, por edhe rrushit, ne si bujq i kemi prodhuar duke llogaritur në tregun e Kosovës. Asgjë nuk është bërë, përderisa nuk hiqen taksat edhe për specat, domatet, rrushin... kërkojmë që Qeveria jonë të përgjigjet me kundërmasa”.

“Rritja e taksave doganore për 30 për qind ka bërë të mos ketë kërkesa dhe përderisa nuk ka kërkesë në treg, është e kuptueshme se çmimet e pemëve dhe perimeve për çdo ditë bien. Jo vetëm që janë përgjysmuar, por edhe më



keq, prodhimet bujqësore kalben në treg sepse nuk ka kërkesa. Bëhet fjalë për domate, kumbulla, tranguj që për dy-tre ditë nëse nuk shiten ato kalben. Shpresoj të ketë një zgjidhje sa më parë. Njëherësh kërkojmë që edhe autoritetet shtetërore të gjejnë një zgjidhje për të ulur koston e dëmit që kemi pësuar së fundmi ne si bujq” thotë për Radion Evropa e Lirë, Eftim Shaklev, kryetar i Asociacionit të Bujqve në Maqedoni.

Bujqit në Maqedoni bëjnë të ditur se rritja e doganave për prodhimet bujqësore që futen në

Kosovë për 30 për qind, masë kjo që hyri në fuqi më 18 korrik, vetëm brenda një jave atyre u ka shkaktuar dëm në vlerë mbi 3 milionë euro.

Për shkak të mungesës së plasimit të produkteve në treg, çmimet e pemëve dhe perimeve në tregjet e Maqedonisë janë përgjysmuar.

Aktualisht, në tregjet me shumicë, me 1 euro mund të blihen 6 kilogramë domate, ndërkaq me çmimin e njëjtë, para një jave mund të bliheshin vetëm 3 kilogramë.

Me vetëm 1 euro mund të

blihen 12 kilogramë kumbulla, apo 12 kilogramë tranguj, dyfish më lirë sesa kushtonin vetëm një javë më parë. Edhe tregtarët ankohen se pësojnë dëme të mëdha, duke bërë të ditur se nga 100 tonë prodhime bujqësore sa janë eksportuar për çdo ditë në Kosovë, javën e fundit, në ditë janë nisur vetëm 5 tonë pemë dhe perime.

“Duhet të ketë përgjegjësi për mosrespektimin e plotë të marrëveshjes së CEFTA-së. Të gjithë ne kemi shumë dëme. Rritja e taksës doganore duhet të shfuqizohet për të gjitha prodhimet bujqësore dhe jo pjesërisht”, thotë tregtari, Ivan Teodorov.

Njohësit e çështjeve ekonomike thonë se përplasjet mes Shkupit dhe Prishtinës rreth mbrojtjes së prodhimeve bujqësore, nuk po shfaqen për herë të parë dhe këto përplasje duhet parë si fotografi më e gjerë, kur edhe Shkupi në vitin 2013 morri vendim që të mbrojë një pjesë të prodhimeve të tij, siç ishte mielli dhe pro-

duktet e qumështit.

Arben Halili, ish-drejtor i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore vlerëson se në favor të ekonomisë së Maqedonisë edhe Kosovës është që të respektohet në tërësi marrëveshja e CEFTA-s, dhe jo të bëhen shkelje të herëpashershme për produkte të caktuara.

“Që të dyja palët duhet të respektojnë marrëveshjet e ndërsjella dhe mbi të gjitha të shohin interesin e përgjithshëm të ekonomisë dhe mos përqendrohen vetëm në një ose dy sektorë në momente të caktuara”, thotë Halili.

Ndryshe, Kosova më 18 korrik, për të mbrojtur prodhimet bujqësore të vendit, vendosi të rrisë taksën doganore për 30 për qind për produktet bujqësore që futen në tregun e Kosovës, nga të gjitha vendet e rajonit. Si më e goditura nga ky vendim llogaritet Maqedonia, si shtet prej ku është furnizuar një pjesë e madhe e tregut të Kosovës me pemë dhe perime. /REL

Republika e Maqedonisë



KOMUNA E BEROVËS
Numri arkivues 04 - _____/1
26.07.2018

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 2, paragrafi 3, paragrafi 8, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 25/2018), nenit 22, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/2016 dhe 120/2018), , në pajtim me nenin 11 nga Ligji për zjarrfikës (Gazeta Zyrtare e RM nr. /2004, 81/2007, 55/2013, 158/2014, 193/2015, 39/2016 dhe 168/2017), Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Komunën e Berovës numër 01-1017/1 të datës 29.12.2015, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Komunën e Berovës numër 01-1117/2 të datës 13.04.2016, 01-1566/2 të datës 15.16.2016, 01-2593/4 të datës 19.12.2016, 01-317/1 të datës 22.03.2017, 01-389/1 të datës 30.01.2018, 01-1868/1 të datës 01.06.2018, në pajtim me Lajmërimin për mjetet e siguruar financiare nga Ministria e punëve të brendshme numër 18-6554/3 të datës 26.06.2018, Kryetari i Komunës së Berovës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR - 01/2018

Për punësim për kohë të caktuar për shkak të rritjes së përkohshme të kapacitetit të punës në Njësinë territoriale të zjarrfikësve pranë Komunës së Berovës të 2 (dy) realizuesve - persona të autorizuar zyrtar nga sfera e sigurisë

Komuna e Berovës për shkak të rritjes së përkohshme të kapacitetit të punës, publikon shpallje publike për punësim të 2 personave për kohë të caktuar derisa të zgjatë nevoja për institucionin, ndërsa më së shumti përfundimisht me datën 31.12.2018 për vendin e punës në vijim:

(1) Zjarrfikës shpëtues shifra nr. POZH0210V04000 Njësinë territoriale të zjarrfikësve – **2 realizues**, për kohë të caktuar të punës përfundimisht me datën 31.12.2018, të cilët do t' kryejnë detyrat e punës për vendin e caktuar të punës, me bruto pagesë prej 16.500,00 denarë.

Kushtet e përgjithshme të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Në momentin e parashtrimit të fletëparaqitjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kualifikimet e nevojshme të cilat duhet të përmbushen, përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune janë:

- niveli i kualifikimit IV sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve me 180 apo 240 kredi të fituara sipas ECVET apo MKSOO apo së paku arsim të mesëm apo të lartë, me ose pa përvojë pune në profesion, patentë shoferi kategorinë C certifikatë për kualifikim të fituar për zjarrfikës;

Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët e interesuar janë të obliguar që të parashtrorjnë dokumentacionin e nevojshëm në vijim:

- Fletëparaqitje të nënshkruar me dorë për vendin e punës për të cilin paraqiten (mund të merret në Seksionin për udhëheqje me resurse njerëzore në Komunën e Berovës);
- Biografi të shkurtër CV jo më të madhe se 5 faqe, me kontakt të nevojshëm të theksuar dhe adresë dhe letër motivimi me jo më shumë se 500 fjalë;
- Certifikatë të shtetësisë origjinal apo kopje të verifikuar në noter;
- Dëshmi për përvojën me parashtrim të historialit për punësim nga Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë;
- Diplomë apo kopje të diplomës të verifikuar në noter për shkallën e mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës;
- Certifikatë nga mjeku për aftësi të përgjithshme shëndetësore si kusht i përgjithshëm për themelimit të marrëdhënies së punës, e nënshkruar nga mjek i mjekësisë specialist i mjekësisë së punës, e dhënë nga organizata shëndetësore nga sigurimi shëndetësorë primar e cila e kryen veprimtarinë mjekësore;
- certifikatë për kualifikim të fituar për zjarrfikës;
- patentë shoferi për provim të dhënë - Kategoria C (kopje e verifikuar në noter);

➤ Certifikatë që me akt të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës nga Gjykata themelore;

Kandidatët të cilët në autobiografinë dhe letërën motivuese kanë shënuar të dhëna që kanë të kryer arsim më të lartë nga ajo që kërkohet në shpallje, kanë përvojë pune nga sfera e zjarrfikësit, janë anëtar në shoqata vullnetare të zjarrfikësve, kanë të mbaruar trajnime nga sfera e zjarrfikësve, kanë fituar certifikatë për zjarrfikës, kanë njohuri të gjuhëve të huaja, kanë patentë shoferi me provime të dhëna për kategori tjera shtesë, kanë marrë pjesë në gara sportive apo kanë të shënuara të dhëna tjera, është e nevojshme që për të gjithë ato shënime të dorëzojnë dëshmi përkatëse - dokument në origjinal apo kopje të verifikuar në noter.

Orari i punës për vendin e punës me numër rendor 1) është caktuar me ndërrime, orari i plotë javor është 40 orë apo më së shumti 176 orë në muaj, gjegjësisht 12 orë punë, 24 orë pushim, 12 orë punë, 48 orë pushim.

Dokumentacioni i nevojshëm në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter të dorëzohen përmes arkivit të Komunës së Berovës, Departamenti për menaxhim me resurset njerëzore ose përmes postës në adresën në vijim: Komuna e Berovës, Departamenti për menaxhim me resurset njerëzore, rr. "Dimitar Vllahov" nr. 10, 2330 Berovë. (me shenjë "për Shpallje publike numër 01/2018 për punësim për kohë të caktuar të punës" në anën tjetër të zarfit të shënohet edhe vendi i punës së për të cilin aplikohet).

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes. Afati për parashtrimin e dokumentacionit është pesë (5) ditë duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor, duke mos konsideruar ditën e vet publikimit.

Fletëparaqitjet dhe dokumentacionet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Për shkak të urgjencës së procedurës, fletëparaqitjet parashtrorhen vetëm përmes arkivit të Komunës së Berovës ose përmes postës me rekomandim.

Procedurën për zgjedhje të kandidatëve do ta realizojë Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të komunës së Berovës.

Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve të rregullt, për përzgjedhjen e kryer administrative secili kandidat do të informohet me shkrim, ndërsa kandidatët e përzgjedhur do të ftohen enkas në intervistë dhe testim në lokalet e Komunës së Berovës.

Komuna e Berovës do të realizojë zgjedhje në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune.

Me kandidatët e përzgjedhur do të lidhet marrëveshje për punë në formë me shkrim, pas vendimit përfundimtar për zgjedhje.

Nr. 04 - _____/1
26.07.2018

Komuna e Berovës

Berovë

Kryetari i Komunës
Zvonko Pekevski

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 121/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucionin publik komunal për fëmijë Çerden e Fëmijëve Planinski Svet Vevčan“ për vendet e punës në vijim:

1. DEZ0102V04001 Bashkëpunëtor i ri - Sekretar, Shërbimi për udhëheqje të punëve administrative dhe menaxhim me resurset njerëzore - Shërbimi administrativë 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 17.262,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – rë: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – rë: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – rë.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 124/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Shkollën e Mesme Komunale Mitko Penxhukliski Kratovë“ për vendet e punës në vijim:

1. OBN0102V01001 Këshilltar për punë të përgjithshme dhe normative juridike - Sekretar, Njësia 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, Fakulteti juridik
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 21.541,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – rë: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – rë: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – rë.



Prifti pedofil kapet lakuriq me një vajzë 10-vjeçare

Policia italiane ka vënë në pranga një prift pedofil. 70-vjeçari Don Paolo Glaentzer u kap në makinë me një vajzë 10-vjeçare. Prifti ka pranuar aktin skandaloz dhe për këtë ai u pezullua nga puna e tij si peshkop. Për vajzën e cila prej kohësh është ndjekur nga shërbime sociale, është organizuar mbështetje psikologjike.

Don Glaentzer, pastor i një kisha të dioqezës së Firences, në kufi me provincën e Prato, por që nuk i përkasin klerit fiorentin, u arrestua nga policët me akuzë, dhunë seksuale e rënduar. Duke pasur parasysh moshën e madh të priftit, Prokurori Publik i Pratis ka urdhëruar arrestimin shtëpiak.

Ishte ora rreth 22:00 e mbrëmjes së të hënës. Prifti kishte ndaluar në parkingun e një supermarketi në rrugën në mes të famullisë dhe në shtëpisë së vajzës, të famullisë e tij. Një banor i zonës ka vënë re dy me makinë në një zonë të errët. Së bashku me babanë e vajzës, iu afruan makinës dhe, pasi panë vajzën me pantallona të ulura poshtë, hapën derën dhe e nxorën vajzën jashtë, gjithashtu duke njoftuar fqinjët.

Menjëherë një grup i vogël i banorëve të zonës është mbledhur në parking. Ka pasur rritje të tensionit dhe ofendime, prifti u bllokua dhe vetëm ndërhyrja e një patrulle karabinierësh e pengoi atë nga sulmoni i të pranishmëve. Kjo nuk ishte hera e parë që ai merrte me vete fëmijën. Prifti u çua në stacionin e policisë dhe ai pohoi se kjo nuk ishte hera e parë që diçka e tillë kishte ndodhur, por ai tha se edhe për të kuptuar marrëdhënien e tij me si një marrëdhënie emocionale. Episodet, më shumë se një, kishin ndodhur gjithmonë në makinën e tij, gjatë udhëtimit midis famullisë dhe shtëpisë së vajzës. Përkrahja psikologjike iu ofrua të miturës, shkruan InTv. Karabinierët e Signa po kryejnë gjithashtu hetime për të përcaktuar nëse ka viktimë të tjera të priftit i cili duhej të largohej nga famullia në shtator.

VRASJE NË KRUSHË TË VOGËL

Të enjten, rreth orës 06:30 minuta, Policia e Prizrenit e ka pranuar një informacion që bënte të ditur se një person ishte gjetur i shtrirë në rrugë pran një pompe të karburanteve në afërsi të Stacionit Hekurudhor në Krushë të Vogël.

“Njësite relevante policore po merren me hetimin e rastit. Zyrtarët e emergjencës që ishin në vendin e ngjarjes kanë konfirmuar se viktimë dyshohet të jetë vrarë me armë zjarri. Nuk dihen rrethanat se si ka ndodhur ngjarja dhe as kush ka mundur ta ketë kryer vrasjen. Për informata shtesë do të njoftoheni pasi te kuptojmë më shumë rreth rastit”, njofton Zyra për Informim e Policisë Rajonale të Prizrenit.

Prokurorja kujdestare e cila ishte në vendin e ngjarjes, Ariana Shajkovci, tha për Kallxo.com se kanë mbledhur provat dhe kanë marrë video-incizime nga vendi i ngjarjes, por ende nuk ka të dyshuar, njoftojnë mediat kosovare.

“Sapo u ktheva nga vendi i ngjarjes ku isha nga ora 7 e 15 minuta e mëngjesit që kam qenë atje. Janë mbledhë të gjitha provat nga vendi i ngjarjes dhe janë shkarkuar video incizimet, mirëpo për momentin nuk kemi person të dyshuar”, tha



prokurorja Shajkovci.

Shajkovci tha, gjithashtu, se ende nuk dihet motivi i vrasjes, por dyshohet që vepra të jetë kryer me kallashnikov.

“Sipas policisë dhe ekspertëve dhe lëvizjes së gëzhojave dhe predhave që janë gjet dyshohet që është arma kallashnikov”, tha Shajkovci.

I vrari ishte rojë e marketit, ndërsa orari i tij ishte nga ora 9 deri në 6 e gjysmë të mëngjesit ndërsa prokurorja thotë se sipas informacioneve të pranuar nga familjarët nuk rezultoi se i vrari kishte problem me dikë.

“Nga ana e familjarëve kam kontaktuar njerëzit më të afërt edhe pse e kanë pas shumë të vështirë me fol

në këto momente por vetëm për të ndihmuar që ne të veprojmë më shpejtë ata më kanë thanë që nuk kemi pas konflikt me askënd për aq sa ata kanë njohuri dhe se askush nuk ka pas problem me ne dhe si kemi pas borxh askujt”, tha Shajkovci.

Sipas prokurores ndonëse dyshimi fillestar ishte për ndonjë vjedhje në market, kjo nuk ka rezultuar.

“Edhe pse ne kemi dyshuar fillimisht për ndonjë vjedhje apo grabitje, por lokali ka qenë i paprekur dhe i mbyllur ashtu siç është mbyllur nga ana e punëtorëve apo pronarit kush ka qenë i fundit dhe tani jemi në incizimin e kamerave dhe të shohim se çfarë do të ndodhë më tej”, ka thënë për Kallxo prokurorja Shajkovci.



Burri pa penis akuzohet për agresion seksual

Një agresor seksual në Skoci, i cili mashtrroi dy gra duke përdorur një objekt të panjohur në errësirë, ka përfunduar në regjistrin e krimeve seksuale. Carlos Delacruz, 35 vjeç, ka pasur marrëdhënie me dy gra dhe përdorte një instrument të panjohur në vend të organit të tij.

Të dyja viktimat janë ankuar se kanë provuar “dhimbje ekstreme” gjatë marrëdhënies me Delacruz dhe ishin të detyruara të ndalonin, duke vuajtur nga dhimbjet edhe më pas. Delacruz, banues në Banknock, pranë Falkirk, nuk i linte gratë ta shihnin të zveshur dhe gjithmonë kryente marrëdhënie me dritat fikur.

Të dyja gratë u tronditën kur zbuluan që Delacruz nuk kishte penis dhe kishte përdorur një objekt të panjohur. Delacruz pranoi dje në gjykatë penetrimin e të dyja grave me objektin e panjohur, pa miratimin e tyre. Ai ka pasur marrëdhënie me të dyja gratë në periudha të ndara midis 27 majit 2013 dhe 14 majit 2017.

“I akuzuar kishte marrëdhënie me një grë nga gratë midis majit 2013 dhe janarit 2016. Për herë të parë bënte seks në maj 2013. Ajo besonte se penetrohej nga penisi i tij. I akuzuari nuk ka penis”, tha prokurorja e çështjes. “Ajo e dinte që ai ishte i vetëdijshëm për trupin e tij dhe gjithmonë mbante veshur një bluzë. Gjatë marrëdhënies, ai mbante dorën në bazën e penisit”. Delacruz u ekzaminua nga mjeku dhe u vërtetua që nuk kishte penis. /d.i.SYRI.NET

Grabitet dhe vidhet i riu nga Shkup

Një dramë e vërtet ka ndodhur të mërkurën pas mesnate në banesën e 20 vjeçarit V.D nga Shkupi. Sipas raportit policor rreth orës 12.00, në banesën e të riut në rrugën “Pariska”, janë futur tre persona me maska në kokë, të cilët e kanë mbajtur peng të riut deri në orën 2.30.

Gjatë daljes nga banesa njëri prej personave madje me thikë e ka therur 20-vjeçarin. Ata nga ndërtesa kanë arritur të marrin para, telefon celularë dhe laptop. V.D ka thirrur policinë për të rrëfyer tmerrin që ka përjetuar ndërsa më pas është dërguar për kurim në spitalin “Nënë Tereza”.

Policia nuk ka dhënë detaje shtesë lidhur me



ngjarjen por vetëm ka informuar se është vënë në kërkim të sulmuesve dhe se po punon në zbardhjen e plotë të rastit. /SHENJA/



Të enjten në ambientet e Gjykatës e Apelit në Vlorë ka ndodhur një sherr me sende të forta. Ngjarja ka ndodhur në hyrje të Gjykatës ku 7 persona janë konfliktuar me njëri-tjetrin duke pësuar lëndime trupore.

Tentoi të vriste veten

Sipas zbardhjes së rrethanave të ngjarjes, palët ishin në përfundim të një procesi të gjatë gjyqësor ku shkak ka qenë pronësia për një pikë mermeri në fshatin Lepenicë të Vlorës.

Pesë persona kanë goditur dy të tjerë ndërsa në pritje të vendimit, për shkak të zhvillimeve jashtë Gjykatës, seanca është pezulluar për një afat të pacaktuar. Vetëm disa ditë më parë, një nga personat e përfshirë në konflikt, ka tentuar ti japë fund jetës, ndërsa i kishte lënë edhe mesazh familjarëve të tij. /albeu.com/

Vdes nga zjarri një grua e Kumanovës

Një grua 71-vjeçare ndërroi jetë në zjarrin që mbrëmë ka shpërthyer në shtëpinë e saj në fshatin Dobroshane të Kumanovës.

Siç njoftohet nga policia, mbrëmë rreth orës 20:40 është denoncuar se në fshatin Dobroshane,

në vendin e quajtur “Uji i ftohtë”, në shtëpinë e pronares M.L. (71) ka shpërthyer zjarr. Nga lëndimet e marra nga zjarri, M.L ka ndërruar jetë. Zjarri është shuar nga ekipi i Njësisë kundër zjarrit në Kumanovë. Ekspertizë do të kryhet gjatë ditës së sotme.



Më kujtohet shumë mirë dita kur për herë të parë nga unë u kërkua që ta shkruaja një editorial.

Kam qenë pjesë e redaksisë së 'The Spectator' dhe kjo detyrë, në mënyrë të zbehtë, figuronte në përshkrimin e punës sime dhe kërkesa nuk ishte tërësisht befasi. Por, papritmas më erdhi në mend se unë, në të vërtetë, kurrë nuk kisha lexuar ndonjë editorial në 'The Spectator' ose kudo tjetër. Në baza të përgjithshme e dija se çka ishin editorialet. Por, çfarë gjërash ato thoshin dhe si i thoshin gjërat? Çfarë toni kishin adaptuar? Çfarë parimesh të autorit kishin? Absolutisht nuk kisha ndonjë ide.

Gjithashtu më kujtohet, shumë mirë, kur e pranova një e-mail nga kujdestari i Kolegjit që më ftonte në emër të tij dhe të profilit, që të mbaja një mesazh. Tashti, do të ishte absurde të pretendoj se kurrë nuk kam lexuar ose dëgjuar ndonjë mesazh.

Vite të shumta të shërbimit tim si anëtar i korit—gjatë rinisë sime—do të ishin kundër pretendimit. Megjithatë, është gjë e rrallë të dëgjoni mesazh që jepet nga dikush i cili nuk është as përfaqësues i religjionit e madje as besimtar religjioz.

Dhe, vështirësitë e mija nuk u lehtësuan nga sugjerimi i kujdestarit që unë të flisja për Islamit dhe Krishterimin—një temë për të cilën unë sigurisht që do të ligjëroja si historian apo do të shkruaja, madje, një editorial (nëse eventualisht do t'i kisha mësuar rregullat).

Disa nga mesazhet më të mira joreligjioze që i kam dëgjuar, kanë qenë të karakterit të autobiografisë dhe reflektive personale. Prandaj, shpresoj se do të më falni nëse, sa për fillim, nisem në këtë drejtim. Si student i fakultetit kisha marrë një shprehje që çdo vit ta mësoja nga një gjuhë ballkanike dhe t'i kaloja pushimet verore duke udhëtuar në rajon—veçanërisht në pjesët ku kishte male me shtigje për ecje dhe fshatra të largëta ku do ta kaloja natën.

Bosnja ka qenë një nga ato vende që i kam vizituar në këtë mënyrë, edhe pse nuk ishte e para. Kur pas disa viteve shkova në këtë vend, në nivelin e vetëdijes nuk jam befasuar kur pashë fshatra myslimane (para se gjithash kam dijtë pak histori). Por, mendoj se për çdo evropian perëndimor, eksperiencia e zbritjes poshtë nga malet e larta dhe të hasurit në fshatra të vogla që mbështillen si çerdhe rreth xhamisë me minare sikur lapsi (me siguri ndër format më të bukura të arkitekturës që janë bërë ndonjëherë) do të bartte me vete, në ndërdije, një ndjenjë shqetësuese të frikës. Një ndjenjë e lehtë e ekzotikes—apo ndjenjë për të huajen? Ndoshta kjo do të shoqërohej me pyetjen nxitëse mentale: 'çka kërkojnë këta njerëz në Evropë?' A nuk është religjioni i tyre 'aziatik'?

Si duhet të veprojmë me islamin radikal?

(Predikim i mbajtur më 10 qershor, në Kishën e All Souls College të Universitetit të Oxfordit)

"BOSHNIKËT MË PAK EVROPIANË", ËSHTË NJË PARAGJYKIM

Vite më vonë u njoha me Enes Karriqin, ministër i Bosnjës për Arsimit gjatë pjesës së fundit të luftës, i cili është një dijetar i dalluar islamik dhe përkthyesi i parë i tërë Kuranit në gjuhën boshnjake. Ai më tregoi se kurdo që e vizitonin politikanët [evropianë] dhe që ia bënin këtë pyetje, ai e jepte një përgjigje të thjeshtë: 'Po, religjioni im është nga Azia. Prej atje vjen edhe jehudizmi, sikurse edhe krishtenizmi'.

Por, çfarëdo që ka mundur të thuhet apo të mos thuhet në ndërdijen time, përvoja ime e bisedave me myslimanët boshnjakë dhe qëndrimi im në shtëpitë e tyre më kanë krijuar ndjenjë se kjo është në kundërshtim me të qenurit i huaj: kjo është një botë familjare, e ngrohtë, ku unë kam hasur në kodet e njëjtë të forta të mikpritjes, zemërgjerësisë, nderit, e kështu me radhë, që i kam hasur edhe në mesin e fqinjëve të krishterë në vende të ndryshme të Ballkanit. Të thuhet se ata ishin, në çfarëdo mënyre, më pak evropianë, nuk është vetëm e pavërtetë, por gjithashtu, në mënyrë të qartë, është paragjykim sikur të thuhej njësoj edhe për hebrenjtë a Ballkanit.

Kur në fillim të 1990 Slobodan Millosheviqi e orkestroj fushatën e tij gro-

teske, të ushqyer me propagandë të paranojës, kundër myslimanëve boshnjakë; kur në vitin 1992 filloi lufta në Bosnjë me sulmet e paramenduara nga forcat serbe kundër fshatarëve të pambrojtur boshnjakë; dhe, kur disa pjesë të mediave evropiane reagon—duke deklaruar—se duhet të ketë diçka në atë që e thoshin ekstremistët serbë, jam brenjosur thellë. Paragjykimet kundër këtyre myslimanëve janë përkrahur nga një mori e shtrembërimeve dhe falsifikimeve të historisë së Bosnjës; kundërshtimi i këtyre falsifikimeve më shtyri që të shkruaja një libër dhe që të futesha në botën e aktivitetit politik në të cilin shumë myslimanë të këtij shteti [Britani] kanë qenë gjithashtu të përfshirë. Dhe, pas kësaj ndodhi edhe Kosova, si dhe më shumë vite të përfshirjes sime, që gjatë gjithë kohës ma morën tërë energjinë time mendore.

Nuk dëshiroj të them asgjë më shumë për ato vite, pos atë që në rastin e Bosnjës nuk mund ta lë pa përmendur ndjenjën time që thotë se këtu janë aplikuar standarde të dyfishta. Nëse kudo në Evropë do të rrethohej një qytet me shumicë të krishterë dhe do të bombardohej qëllimisht me artileri nga forcat myslimane, unë nuk besoj që bota do nuk të qëndronte duarkryq e të bën-

Evetmja zgjidhje e problemit të islamizmit radikal do të vijë nga myslimanët e zakonshëm të cilët nuk dëshirojnë të radikalizohen për arsye se ky proces do t'i eliminonte aspektet të cilat janë vet islami. Për pyetjen se 'cili është islami i vërtetë?' ekziston vetëm një përgjigje: është ai që myslimanët e zakonshëm mendojnë se është. Është sikur kur pyetni 'çfarë zëri nxjerr violina e mirë?', ku përgjigja është: çfarëdo që beson violinisti i mirë.



te sehir gjatë—më shumë se tri vite—sikur që bëri me rastin e Sarajevës. Përafërsisht, pas një viti të përfundimit të luftës në Bosnjë, në një hotel të një vendi të huaj e lëshova televizorin dhe e pashë një raportim (më duke se kanali quhet Euronews) në lidhje me situatën e pasluftës. Kamera përqendrohej më shumë se që duhet mbi njerëzit në një xhami të një fshati të zakonshëm, që fale-shin, kurse zëri që e shoqëronte thoshte: 'Hija e islamit ka rënë mbi Bosnjë. A mundet dikush ta imagjinojë një raportim, ta themi për Lituaninë pas përfundimit të sundimit sovjetik, me një incizim të njerëzve duke u lutur në një kishë katolike dhe me fjalë që thonë: 'hija e krishterimit ka rënë mbi Lituaninë'? Unë nuk mund ta imagjinojë këtë.

Millosheviqi dhe përcjellësit e tij kanë patur dëshirë të thonë se e kanë mbrojtur civilizimin e krishterë kundër kërcënimit të ekstremizmit islamik. E kundërta ka qenë e vërteta. Mu veprimet e tyre kanë qenë agresive, madje në mënyrë të hapur, pasi që të krishterët ekstremistë janë përkrahur haptas nga patriarku Pavle i Kishës Ortodokse Serbe. Dhe, si pasojë, këta i radikalizuan myslimanët të cilët më parë nuk ishin radikalë. Duke i lexuar



Nga Noel MALCOLM

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovassja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp dhe distribuim: 'Adria Media Balkan' - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 26 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

lajmet në gazeta për të dënuarit britanikë dhe myslimanë tjerë për terrorizëm gjatë dy dekadave të fundit, unë jam prekur nga fakti se sa shpejt ata thonë se kanë qenë imazhet e vrasjeve të myslimanëve në Bosnjë që i kanë shtyrë në këtë rrugë.

E PËRBASHKËTA E JEHUDIZIMIT, KRISHTENIZMIT DHE ISLAMIT

Sot, natyrisht, islami radikal është një nga problemet e mëdha me të cilat ballafaqohet bota. Ekziston një masë serioze e shkrimeve për këtë nga akademikët dhe komentuesit të cilët as që kam mundësi të provoj që shkurtimisht t'i përmbledh këtu. Por, në një meshë mund të jetë e përshtatshme që të them diçka, sado shkurtazi, në lidhje me aspektin religjioz të këtij problemi: Çfarë duhet të krishterët t'i thonë religjionit i cili, siç duket, kërkon nga përcjellësit e vet që këta t'i përgojnë dhe madje edhe të bëjnë luftë të shenjtë kundër tyre?

Gjatë shekujve të krishterët kanë adaptuar dy qasje kryesore, duke u përpjekur që të gjejnë bazë të përbashkët me islam. Një qasje është tërësisht teologjike, që thekson monoteizmin e të dy besimeve duke e vënë para doktrinën e trinitetit (e cila i largon aq shumë teologët myslimanë) në parimet e filozofisë treshe të fuqisë së përsosur, dashurisë dhe dijes e cila nënkuptohet në konceptin e Zotit. Për të krishterët unitarianë, të cilët e kanë braktisur tërësisht trinitetin, islami mundet nganjëherë që të shihet si gati një model i rreptë i besimit monoteist që e çmon Krishtin si njeri të shenjtë. Në vitin 1682, një grup i unitarianëve të Londrës, në fakt i ka dërguar një letër ambasadorit të Marokut me të cilën e lavdëronte islam dhe propozonte me shpresë që ata mund të bëjnë ndonjë përmirësim të vogël. Më herët gjatë atij shekulli, një iniciativë e ngjashme ka ardhur nga drejtimi i kundërt: një shkrimtar mysliman e ka falsifikuar, siç kishte deklaruar ai, njërin nga ungjijtë – atë të Barnabasë (një tekst "të shenjtë" në të cilin ai në mënyrë të vazhdueshme kishte bërë me dije se Krishti ka qenë vetëm njeri). Kjo vepër qarkullon me të madhe në botën myslimane. Një kopje të përkthimit në boshnjakisht ma ka lënë në dorë një dervish në Sarajevë para shumë viteve. Por, asnjëra nga këto iniciativa, nga asnjëra anë, nuk kanë krijuar urë mbi hendek.

Qasja tjetër ka theksuar gjenealogjinë e përbashkët. Jehudizmi, Krishtenizmi dhe Islami e ndajnë të njëjtën trashëgimi biblike. Siç na kanë thënë, ato janë religjione abrahamicë. Ajo që kjo fjali i referohet në veçanti është tradita e Isakut, të birit të Ibrahimit nga gruaja Sara, që ka qenë paraardhësi i hebrenjve (duke e përfshirë, në fund të fundit, edhe Krishtin); paraardhësin simbolik të myslimanëve Ismailin, të birin e Ibrahimit nga shërbëtorja egjiptiane Hagar [Hagjerja]. Ismaili ka qenë 'çuni' i Gjenezës në kapitullin 21, të cilit Zoti ia kishte premtuar një 'komb të madh'.

Në librin e tij të fundit 'Not in God's Name' (Jo në emër të Zotit) ish-kryerabini Jonathan Sacks shkruan me shumë ndjeshmëri për atë që ai e quan 'rivaliteti i vëllezërve' që përbëhet nga ky tregim. Ai e citon traditën rabine sipas të cilës Ismaili thjeshtë nuk është përgjatur dhe harruar: ai thotë se Ibrahim më vonë i ka shkruar [Ismailit] për vizitë dhe e ka bekuar shtëpinë e tij. Vizioni i Sacksit për religjionet e dy vëllezërve të një babai (apo tri, sipas traditës së trungut tjetër familjar, krishterimit, që është përfshirë gjithashtu) është ofruar si një zgjidhje për problemin e islamit radikal. Por, mjerisht, është vështirë të kuptohet pse radikalët islamistë nuk e shohin në këtë mënyrë dhe pse ajeti i tretë i Kuranit e shpallë Ibrahimin që nuk i takon religjionit të hebrenjve apo të krishterëve por vetëm islamit.

ISLAMI I ZAKONSHËM DUKET SHUMË MË AFËR SE JEHUDIZIMI I ZAKONSHËM

Pikëpamja ime është se të gjitha këto përpjekje për zgjidhjen e problemit në mënyrë teologjike, janë të dënuara me dështim. Sot islami radikal e ka dinamikën e vet që është i lidhur me kushte sociale dhe politike (dhe në disa raste është i ushqyer me shuma të mëdha të parave). Por, mendoj që në nivel më të thellë është gabim të mendohet për islam, thjeshtë në kushte teologjike, si çështje e mbajtjes së një besimi në kokë. Rezistenca më e fortë ndaj islamit radikal bëhet në vendet siç janë Bosnja dhe Kosova dhe nga myslimanët e zakonshëm për të cilët islami është më shumë si çështje se si jetohet, i praktikimit dhe riteve, e disa prej tyre – siç janë adhuruesit e varreve të njerëzve të shenjtë – përjashtohen nga doktrina e re e jotolerancës. Në këto mënyra islami i zakonshëm duket shumë më afër se Jehudizmi i zakonshëm; është çështje se si bëhen gjërat në mënyrë primare e jo nga propozimet që dikush i mban në kokë, siç mund t'i ketë tradita e doktrinalizuar e krishterimit perëndimor. E vetmja zgjidhje e problemit të islamizimit radikal do të vijë nga myslimanët e zakonshëm të cilët nuk dëshirojnë të radikalizohen për arsye se ky proces do t'i eliminonte aspektet të cilat janë vet islami. Për pyetjen se 'cili është islami i vërtetë?' ekziston vetëm një përgjigje: është ai që myslimanët e zakonshëm mendojnë se është. Është sikur kur pyetni 'çfarë zëri nxjerr violina e mirë?', ku përgjigja është: çfarëdo që beson violinisti i mirë. Ky mund të tingëllojë si një argument që sillet në rreth, por nuk është i zbrazët për shkak se në këto raste ne shikojmë në një takëm të vlerave dhe parimeve të cilat janë të brendshme në këtë praktikë; nuk ekzistojnë masa të ndara që vijnë nga jashtë në këtë praktikë. Konkretisht nuk ekziston autoriteti zyrtar për islam. Në islam nuk ka papë apo Këshill të Përgjithshëm siç është për katolicizmin. Dhe, në abstrakt, për islam nuk ka kritere të jashtme apo objektive – veçanërisht jo të parashtrimit të tërë pyetjeve të një pjese të veçantë literare të Kuranit.

Më në fund, çka duhet të bëjnë të krishterët ose, në të vërtetë, myslimanët në përgjithësi, në lidhje me problemin e islamit radikal? Mendoj që, së paku, mund të jap përgjigje negative në këtë pyetje. Është aq me rëndësi që ne nuk duhet të luajmë në duart e radikalizuesve duke folur për islam kinse, nga natyra e tij, është armik ekzistencial. Dëshpërohem çdo herë kur i lexoj komentuesit e Perëndimit (zakonisht gazetarët konservatorë) kur, gati triumfalisht, i citojnë një apo dy ajete të Kuranit, e ku thonë se islami – islami i 'vërtetë' – në thelb është i dhunshëm dhe jotolerant. Islami është ajo që besojnë myslimanët që është dhe ajo që ata e bëjnë si myslimanë. E tërë kjo ka ndryshuar me kohën dhe gjithashtu mund të varet nga pjesët e ndryshme të botës islamike. Kur budallenjtë perëndimorë flasin për këtë religjion se është gjithmonë armiqësor dhe i dhunshëm, mua më kujtohen myslimanët e Bosnjës që i kam njohur duke u nisur nga ata fshatarë që e praktikojnë formën e islamit të tyre tërësisht autentik. Dhe, e di që asnjëherë nuk e kam ndjerë veten më të sigurt se në duart e tyre. Pa dyshim që ka shumë gjëra tjera që mund t'i bëjmë ne apo udhëheqësit tanë politikë – sado në mënyrë indirekte – që t'i përkrahim ata myslimanë që dëshirojnë të vazhdojnë me zhvillimin e islamit të tyre joradikal. Por, kur unë pranova para redaktorit të 'The Spectator' se nuk kisha ide se si shkruhet editoriali, ai ma tha një gjë që më ndihmoi shumë. 'Mos mendo që duhesh të ofrosh zgjidhje, më tha ai. 'Mjafton që ta parashtrosh problemin dhe të skicosh një apo dy parime që duhet t'i ketë në mendje secili që provon ta zgjidhë atë. Mendoj se kjo është një këshillë e shkëlqyeshme për shkruesin e ri të editorialit dhe me siguri edhe për predikuesin.

Përktheu: Daut Dauti

Ndryshimet strategjike në raportet ndërkombëtare dhe shqiptarët



Ilir HAJDINI

Qytetarët shqiptarë duhet të jenë gjithnjë e më të vetëdijshëm se marrëdhëniet ndërkombëtare po ndryshojnë me shpejtësi. Kohezioni i Bashkimit Evropian, ku ne dëshirojmë të integrohemi, po vihet në pikëpyetje nga rritja e numrit të imigrantëve, nga rritja e popullaritetit të partive evropiane të ekstremit të djathtë, nga ndryshimet strategjike amerikane në qasje ndaj tregtisë së lirë dhe aleateve të saj tradicionale, si dhe nga rritja e ndikimit rus e kinez. Kalimi nga marrëveshjet multilaterale tregtare në ato bilaterale mund t'i konvenojë SHBA-së duke pasur parasysh fuqinë e saj politike dhe ekonomike, mirëpo ky ndryshim mund t'i dhurojë një terren të rëndësishëm Rusisë dhe Kinës në arenën ndërkombëtare. Vitin e kaluar mungesa e presidentit amerikan Donald J. Trump në Forumin Ekonomik Botëror të Davosit u shfrytëzua mirë nga presidenti kinez Xi Jinping, i cili shfaqti një alternativë në horizont se Kina mund të mbushë boshllëkun e krijuar nga Uashingtoni në tregtinë globale. Ngjashëm, politika e quajtur "Amerika, e para" e proklamuar nga presidenti Trump dhe kërkesa e tij e hapur ndaj vendeve anëtare të NATO-s se nëse ato nuk investojnë më shumë mund të mbesin të vetmuara në mbrojtje të Unionit ka shqetësuar ndjeshëm disa vende si Gjermaninë dhe Francën, të cilat tashmë kanë filluar të krijojnë një forcë të sigurisë evropiane. Për më tepër, largimi i SHBA-së nga Marrëveshja Bërthamore me Iranin, e cila ishte arritur nën udhëheqjen e përfaqësuesve evropianë dhe fillimi i vendosjes së tarifave amerikane për disa produkte me origjinë nga shtetet evropiane ka thelluar edhe më tutje mundësinë për një luftë tregtare dhe ka rritur ndjeshëm presionin brenda strukturave të polarizuara evropiane që të gjejnë mënyra për të reaguar sa më unanimisht ndaj SHBA-së. Këto zhvillime kanë inkurajuar presidentin e Rusisë se ndoshta ai mund të shërbejë si model për sa më shumë parti të ekstremit të djathtë, siç ka shërbyer edhe për atë të kryeministrit hungarez Viktor Orban. Si rezultat, Rusia mund të shndërrohet në një partner strategjik për disa nga qeveritë që momentalisht gjenden edhe brenda edhe jashtë BE-së duke rrezikuar kështu kohezionin e Bllokut.

Të nderuar qytetarë shqiptarë, në rrethanat e krijuara neve na duhet të dimë se a kanë qeveritë shqiptare

ndonjë plan "B" për skenarë të rinj politikë që mund t'i imponojë koha? Siç na mëson e kaluara, nëse mungon presioni nga shoqëria civile, qeveritë tona edhe ashtu tepër të ngadalshme ndaj çdo rrethanë të re, nuk do ta ndryshojnë kursin e përdorimit të "shkopit magjik të integriteteve evropiane" si përgjigjeje ndaj çdo shqetësimi ose koncesioni ndaj fqinjëve. Nëse SHBA-ja dhe Britania, si dy aleatët më të rëndësishëm të shqiptarëve, po ndryshojnë kurs në arenën ndërkombëtare, si mund të ndodhë që qeveritë e shqiptarëve janë duke qëndruar ende aq indiferente?

Për hir të lexuesit dhe të së ardhmes, më duhet të vazhdoj të shtroj disa pyetje të rëndësishme sugjестive:

A mos vallë do të ishte më mirë që ne të koordinohemi me aleatët tanë që së pari të krijojmë një treg të unifikuar shqiptar në mes dy shteteve tona edhe ashtu të vogla e pastaj të hyjmë si një treg unik shqiptar në marrëveshje bilaterale tregtare me SHBA-në dhe me Britaninë e Madhe? A nuk do të sillte kjo një nxitje të investimeve të huaja drejt vendeve tona nga kompanitë të cilat do të dëshironin të eksportonin në vende me tregje aq të madhe si SHBA-ja dhe Britania? A nuk do ta rriste kjo fuqinë tonë negociuese edhe politike, edhe ekonomike në arena regionale e ndërkombëtare?

Pastaj, a janë qeveritë tona duke iu përgjigjur kërkesave të presidentit Donald Trump për më shumë investime në fushën e mbrojtjes në kohën kur Serbia po eksporton në tregjet tona të ndara jo vetëm produkte, por edhe frikë me aeroplanë sulmues "MIG 29" dhe sisteme "S300" të importuar nga Rusia?

Pse është sasia buxhetore e investuar për zhvillimin e FSK-së ende aq e vogël në krahasim me bruto prodhimin që kemi sidomos në kohën kur gjithnjë propagandohet për transformimin e saj?

Me fjalë tjera, a nuk duhet gjetur mënyra më të mira për të merituar integrimin në qoftë se BE-ja ende do të ekzistonte dhe në qoftë se ky integrim ende do të na konvenonte?

Pyetjet që NE do të dimë të shtrojmë tani dhe insistimi në përgjigjeje që duhet të marrim do të jenë kritikë për të ardhmen e fëmijëve tanë. Nga të gjitha pikat e lartcekura, një është me ndikim thelbësor. Qasja bilaterale e SHBA-së ndaj vendeve tjera, e shoqëruar me largimin e Britanisë nga BE-ja mund të ndryshojë dukshëm jo vetëm raportet ndërkombëtare politike e të sigurisë, por edhe raportet e shteteve shqiptare në mes vete dhe me të tjerët.

(Autori është hulumtues shkencor dhe ligjërues në Universitetin e Vjenës, si dhe fitues i disa çmimeve ndërkombëtare në fushën e aleancave strategjike).

SHQIPËRISË I SHTOHET EDHE NJË ISHULL, VËRSHOJNË TURISTËT

Në këto zona të Shqipërisë ku vetja të duket si në plazhet e Vietnamit ose Tailandës, është e pafalshme të mos shkoni qoftë një herë të vetme... Këto vende fantastike me bukuri përrallore të papërshkrueshme, i përkasin Liqenit të Komanit dhe lumit të Shalës, në zonën e malësisë së Mbi-Shkodrës. Lumi i Shalës me një gjatësi prej 37 km buron tek kroi i Shtrazës në krye të fshatit Theth, në rrëzë të majës së Radohinës, nga ku zbret poshtë nëpër luginë të Shalës, nga Thethi, Ndërlysa e Musha, nga Breg-Lumi tek Porta e Shalës (Gryka e Rrshqëmit), nëpër Lotaj, e në luginën e Shoshit, derisa derdhja e tij shkon në Lesniqe në

Drin (sot liqeni i Komanit).


Aty disa mendje të holla kanë inprovizuar disa plazhe spektakolare dhe një resort tepër original, i cili për pamjet që ofron është vertetë si një copë "Parajsë".

Fotot e këtyre vendeve të rralla kanë bërë tashmë xhiron e botës, ndaj aty kanë nisur të vërshojnë si turistë nga Shqipëria, ashtu edhe të huaj.

Por ajo që mbetet vërtetë mahnitëse është edhe ishulli i vogël në liqenin e Komanit, i cili vitit e fundit ka nisur të mbulohet nga bimësia e harlisur.

Shikoni këto foto që të kuptoni se për çfarë mrekullish po ju flasim.../E.K./Mapo.al/






Legjendat e Prishtinës



Një copë tokë në një fshat të Prishtinës mendohet të jetë shumë më e vlefshme se sa duket në shikim të parë. Kjo pasi pretendohet që në tokë është e fshehur një pasuri e tërë – legjenda thotë që aty ka lira e dukat të moçëm. “Kur është shitë toka e parë, pronari e ka caktu çmimin me lira dhe flitet që ato lira për të cilat është

shitur toka janë të fshehura në këtë pjesë”, thotë një nga vendasit e fshatit Tenezhdoll. Megjithatë, këto mbeten fjalë, pasi që askush ndonjëherë nuk ka gjetur asgjë. Tjetra legjendë flet për pishinën e Gërmisë, për të cilën thuhet që është ndërtuar mbi varreza. Këtë e mohojnë kujdestarët në këtë pishinë.

Mos u ngatërroni, edhe në Afrikë të Jugut ndodhet një Kosovë



Nëse klikoni në Google për të kërkuar lajme për Kosovën, mund të befasoni se ka edhe një Kosovë tjetër që ndodhet shumë larg nga Kosova ballkanike. Është fjala për një vendbanim në Afrikën e Jugut ku së voni banorët po përballen me çështjen e banimit, shkruan Express.

Mirëpo, ky vend i vogël me pak banorë, përballlet me varfëri dhe nuk është i zhvilluar në fushën e infrastrukturës.

Kosova në Afrikën e Jugut është për një qytezë në provincën

e Luvuvya-s, në afërsi të Kampalass që është kryeqyteti i Ugandës.

Uganda është shtet që ndodhet në Lindje të Afrikës, në kufi me Keninë, Republikën Demokratike të Kongos, Sudanin Jugor dhe Republikën Demokratike të Kongos, ndërsa Luvuvya, provinca ku ndodhet “Kosova e Afrikës”, njihet si vend ku ka lulëzuar krimi, në veçanti, grabitjet me armë.

Deri në tetor të vitit 1962, ky vend ishte koloni e Britanisë së Madhe.



Hulumtim: Manat ulin rrezikun e vdekjes nga sëmundjet e zemrës

Sipas hulumtimeve të reja në Britaninë e Madhe, të hash vetëm një grusht mana në ditë ulë rrezikun e vdekjes nga sëmundjet e zemrës deri në 40%. Antioksidantë të njohur si anthocyanins, të cilat japin fruta me ngjyrën e tyre, përmisohen ngurtësi e arterieve, ulë presionin e gjakut dhe reduktimin e inflamacionit, transmeton Klan

Kosova. Rreth 16 për qind e vdekjeve që lidhen me zemër, në vendet e zhvilluara janë shkaktuar nga një mos konsumimi i frutave, thotë ndër të tjera ky hulumtim. Ndërsa nga hulumtimet e mëparshme thuhet se arsye e mos konsumimit të frutave janë dietat e varëfra të cilat pastaj llogarit edhe si shkaktar u vdekjeve në mbarë botën.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejtshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 125/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucionin publik komunal për fëmijë Çrden e Fëmijëve Majski Cvet - Manastir“ për vendet e punës në vijim:

1. DEZ0102V01002 Këshilltar - kontabilist, Shërbimi për punë administrativë dhe menaxhim me resurse njerëzore I realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveu i kualifikimeve VI A sipas kategorizimit maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkenca ekonomike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjike
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
- Rroga neto: 20.055,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonac(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësimit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësimit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

KOMUNA E GOSTIVARIT

ОПШТИНА ГОСТИВАР

GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-980/5

23.07.2018

Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M Ě R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë se për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik **për formimin e parcelave ndërtuese në PKnr.872/1 dhe PKnr.872/2 KK Banjicë me dedikim G2**-Komuna e Gostivarit Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizim e :

PREZANTIMI PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelave ndërtuese në PK nr. 872/1 dhe PK nr. 872/2 KK Banjicë me dedikim G2** - Komuna e Gostivarit me përfshirje projektuese prej **14034,5 m²** që kufizohet me:

- Nga ana veriore me rrugën ekzistuese

-Nga ana jugore me rrugën ekzistuese

-Nga ana lindore me rrugën ekzistuese

-Në anën perëndimore me parcelën kadastrale PK nr. 877/1 dhe PK nr. 869/2

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit respektivisht në sallën e Këshillit të Komunës së Gostivarit më **30.07.2018 (e hënë) në ora 13:00.**

Projektin Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelave ndërtuese në PK nr. 872/1 dhe PK nr. 872/2 KK Banjicë me dedikim G2** - Komuna e Gostivarit do të ekspozohet në mjediset e Komunës së Gostivarit do të zgjasë 5 ditë pune prej **30.07.2018** deri më **03.08.2018** çdo ditë pune prej **orës 08:00-16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridikë dhe fizikë mund të parashirojnë vërejtjet me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari



REPUBLIKA E MAQEDONISË



Çerdhja publike për fëmijë Srnička e Komunës së Aerodromit në Qytetin e Shkupit

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014; 199/2014 dhe 27/2016), nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015 – tekst i pastruar; 27/2016), nenit 143 paragrafi 3 pika 1 e Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013; 12/2014; 44/2014; 144/2014; 10/2015; 25/2015; 150/2015; 192/2015; 27/2016) dhe Rregulloren për elementet e domosdoshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe formës, përmbajtjes dhe mënyrës së udhëheqjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të përvetëta gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/2015), ÇPFKA SRNIČKA – Shkup publikon:

SHPALLJE PUBLIKE NR. 03/2018

Për punësim për kohë të pacaktuar të 1 (një) personi – ofruar të shërbimeve dhe 1 (një) person teknik-ndihmës për vendet e punës në vijim:

1. DE3 0303 G01 001 – Përkëdhelës niveli I – 1 (një) realizues

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënime ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënime me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të mitur, moskudese dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.

Kushtet e posaçme

- arsim të mesëm katërveçar të mbaruar dhe licencë valide për përkëdhelës

- Përvojë pune: me ose pa përvojë pune

Orari i punës

- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte

- Orët e punës në javë 40 orë

- Orari i punës prej ora 07:00 -15:00

Neto shuma e pagesës në të holla: 14.772,00 denarë

Afati për paraqitje është 5 ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë Fletëparaqitje për punësim me bashkëngjitje të dokumentacionit në nevojshëm në vijim:

- diplomë/dëftesa për arsimin e mbaruar përkatës – original ose kopje të vërtetuar në noter;
- certifikatë të shtetësisë;
- certifikatë të mjekut;
- deklaratë të shkruar me dorë nga kandidati se njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik;
- dëshmi nga gjykata kompetente se kandidatit nuk i është shqiptuar dënime ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- dëshmi nga gjykata kompetente se kandidati nuk i është shqiptuar dënime me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskudese dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese;
- licencë valide për edukator - original ose kopje të vërtetuar në noter

Fletëparaqitjen për punësimin kandidatët mund ta marrin nga drejtoria e ÇPFKA SRNIČKA – Shkup në adresën në vijim: bul. “Jane Sandanski” nr. 29A – Shkup.

Fletëparaqitjen për punësim me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët duhet ta dorëzojnë në formë të shkruar deri në arkivin e ÇPFKA SRNIČKA – Shkup ose përmes postës në adresën në vijim:

ÇPFKA SRNIČKA – Shkup

bul. “Jane Sandanski” nr. 29A – Shkup

(me shenjë: “Për shpallje publike nr. 04/2018”)

Personi për kontakt – Janko Ralev tel. 072-247-508.

Kandidatët janë të obliguar që të dorëzojnë të dhëna të precize dhe të sakta.

Selektimin dhe intervistën e kandidatëve të paraqitur do ta realizojë Komisioni kompetent, i formuar për realizim të procedurës për punësim.

Kandidatët e paraqitur do të informohen në kohë për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.

Fletëparaqitjet dhe dokumentacionet e dorëzuara pas afatit, të pakompletuara dhe jo të plota nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit.

ÇPFKA SRNIČKA – Shkup

Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopištes

Tel:++389 2 27 85 100

Faks: ++389 2 27 85 109

Rr. 2, Nr 2, f. Sopište, 1054

Shkup, Republika e Maqedonisë

www.opstinasopiste.gov.mk

Nr. i procedurës: 16256
Nr. 28-48/18 nga 24.07.2018

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për Dokumentacionin lokal urbanistik planor me qëllim A1- shtëpi banesore për formimin e GP për pjesë të PK 590/1 dhe PK 601, KK Sopište - vgr.

Bëhet zbatimi i prezantimit dhe anketës publike për Dokumentacionin lokal urbanistik planor me qëllim A1- shtëpi banesore për formimin e GP për pjesë të PK 590/1 dhe PK 601, KK Sopište - vgr.

Përfshirja planore dokument për Dokumentacionin lokal urbanistik planor me qëllim A1- shtëpi banesore për formimin e GP për pjesë të PK 590/1 dhe PK 601, KK Sopište - vgr është me sipërfaqe prej 5311 m².

5. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopištes më datë **06.08.2018** në ora **11.00.**

6. Anketa publike do të zgjasë deri më **10.08.2018**, në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

7. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.

8. Informata në tel. 2 785 102

Udhëheqës i seksionit për Urbanizëm
Aleksandar Dimovski

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m² me markë ndërtimore 430 m², lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në “Momin Potok” – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithej 180 m²). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Koha <http://www.koha.mk>

Koha

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, I Q.T. Mavrovrasja lok.14 - përdhësë, Shkup

JA SI TEKNOLOGJIA DIGJITALE PO NDRYSHON FËMIJËRINË

Janë të shumta kritikave që vijnë në drejtim të mënyrës sesi smartfonët po ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve. Madje kur edhe veteranët e teknologjisë si themeluesi i Napster, Sean Parker, bashkohen me zërin e kritikave, atëherë qartazi duket se do të vijin ndryshime.

Në 2017, Parker paralajmëroi se mediat sociale "ndryshojnë dukshëm marrëdhënien tuaj me shoqërinë, me njëri-tjetrin...".

Këshilli i Evropës kohët e fundit ka nxjerrë rekomandime për të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital, duke u bazuar në kuadrin ligjor të DPPM-së, i cili përcakton kufijtë e pëlqimit të fëmijëve për përdorimin e të dhënave të tyre.

Ka më shumë vetëdije se kurrë se teknologjia në fëmijëri duhet të kontrollohet si duhet nga të dyja palët, qeveria dhe prindërit.

Për t'ju ndihmuar të kuptoni disa nga çështjet e përfshira, këtu janë pesë mënyra në të cilat ekranit po riformulon jetën e fëmijëve.

NDRYSHIMET FIZIKE

Mbizotërimi i teknologjisë që në vitet e hershme – një e pesta e fëmijëve të moshës tre dhe katër vjeçare kanë tabletët e tyre.

Shfaqja e obezitetit, dhimbjeve të shpinës, qafës dhe të tjera si këto kanë një shkaktar të përbashkët, teknologjinë.



Por me rritjen e numrit të aplikacioneve dhe pajisjeve që mundësojnë monitorimin e niveleve të aktivitetit fizik, në arrijmë sërish në të njëjtën pikë, përdorimi i një zgjidhje që gjithashtu është dixhitale.

NDIKIMI NË TRU

Dizajni i tërheqës i shumë videove dhe aplikacioneve ndikon në trurin e fëmijëve. Shumë prej tyre janë të strukturuar rreth shpërblimeve, të cilat rregullisht japin stimuj, duke nxitur vazhdimin e lojës.

Funksionet Autoplay në YouTube dhe uebfaqe të tjera video përforcojnë këto ritme. Si një

zgjidhje e mundshme shihet fikja e funksionit Autoplay duke shmanjur nxitjen ndaj fëmijëve

HAPËSIRË, JO KOHË

Mes gjithë këtyre ndikimeve vlen të kujtohet se ndoshta teknologjia po i bën fëmijët të ndryshëm nga ne. Edhe studimet e hershme të efekteve të videove treguan se ata përmirësuan arsyetimin hapësinor.

Ndërkohë që aftësitë verbale, argumentet logjike dhe përqëndrimi i vëmendjes mund të kërkojnë më shumë inkurajim jashtë linje, shumica e të vegjëlve do të përfitojnë nga koordinimi i përshejtuar i syve dhe aftësitë për njohjen

e imazhit, si dhe shkathtësia e përgjithshme digjitale që tani është thelbësore për t'u rritur.

PËRCAKTIMI I FËMIJËRISË

Një tjetër aspekt në të cilin epoka digjitale po shtrin efektin e saj, është edhe tronditja kufijve të jetës. Ndërsa viti i parë i shkollës së mesme mund të konsiderohet si një moshë e paracaktuar për një fëmijë për të marrë smartphone e parë, 39% e 8 deri 11-vjeçarëve tashmë i kanë ato.

Hyrja në botën e mediave sociale papritur u jep fëmijëve të papjekur një hapësirë relativisht të pavarur në të cilën të provojnë "sjellje të rrezikshme" që ata nuk mund

të kuptojnë ose të përballojnë domosdoshmërisht, sipas raportit të 5Rights.

Përplasja mes grupmohave të papërshtatshme dhe sjelljeve që sjell media sociale do të thotë që fëmijët dhe të rriturit duhet të kuptojnë përgjegjësitë e tyre përkatëse nën kompaktin e ri dixhital.

NDIKIMI NË SHËNDETIN MENDOR

Ka pasur shumë diskutime për ndjenjën në rritje të pamjaftueshmërisë dhe vetmisë të nxitur nga mediat sociale dhe ndikimin e saj në shëndetin mendor të të rinjve.

Adoleshentët që shpenzojnë më shumë se tre orë në ditë në internet kanë 35% më shumë gjasa të jenë në rrezik vetëvrasjeje, sipas një studimi të fundit të SHBA.

Dekada e fundit ka parë një ndërgjegjësim në rritje dhe ndjeshmëri ndaj çështjeve të shëndetit mendor.

Pjesa më e madhe e këtij diskutimi po mbahet nga të rinjtë në mjedisin që është më i natyreshëm – si dhe diskret për ta: interneti.

Nuk ka asnjë dyshim se kufiri i ri dixhital po redukton në mënyrë drastike fëmijërinë, duke kërcënuar trupat dhe mendjet e ndjeshme.

Por ndoshta ne mund t'i përbushim këto sfida nëse ato trajtohen në frymën e parimit origjinal të internetit: diskutim i lirë dhe i sinqertë.



Ky është xhami i ri që do t'i ofroj mbrojtje maksimale telefonit tuaj

Xhami i njohur si Gorilla Glass 6 i cili bën mbrojtjen e fytyrave të telefonave të menqur si Apple, Samsung, LG e shumë të tjerë, ka ardhur me një trend të ri, përcjell "Zeri.info"

Ky xham i ri mbrojtës është shumë efikas pasi edhe pas rënies, xhami i vërtetë mund të mos thehet edhe pas 15 rë-

nieve prej një metërshë (39 inç).

Gorilla Glass 6 është më shumë se dy herë më e qëndrueshme se Gorilla Glass 5 në pika të shumta mbijetuese, në të njëjtën kohë kanë konfirmuar se rezistenca e gërvishtjeve është në të njëjtin nivel siç ishte në Gorilla Glass 5, kështu që nuk ka përmirësim në atë sektorë

Materiali ka arritur në një kohë të përshtatshme sepse shumë prodhues po marrin gjithashtu një mbrojtje prej xhamit për telefonat e tyre, pasi fytyrat e telefonave janë bërë shumë të ndjeshme, ku kosto për të blerë një telefon të ri ka rezultuar të jetë shumë i lartë



Google Docs korrigan gramatikën e tekstit përmes inteligjencës artificiale

Në konferencën vjetor Cloud Next, Google prezantoi një funksion të ri disi të veçantë për Google Docs inspiruar nga "Smart Compose" në Gmail dhe Hangouts.

Bëhet fjalë për një funksion që kontrollon rregullsinë gramatikore të tekstit që shkruajmë. Që nga 1990 Microsoft është përpjekur ta adresojë këtë problem. Por qasja përmes inteligjencës artificiale e Google do të thotë se korrigitet gramatikore do të jenë të një niveli tjetër.

Kjo sepse Google e i trajton korrigitet si problem përkthimi. Në vend që të përkthejë nga frëngjishtja në anglisht, Google Docs do të përkthejë anglishten e çrregullt në anglishten të rregullt.

Në vitet e fundit algoritmet e përkthimit të Google raportohet se kanë arritur nivelin njerëzor për nga saktësia.

THAÇI EDHE ZYRTARISHT: ME SERBINË DO TË DISKUTOHET SHKËMBIMI I TERRITOREVE

Presidenti Thaçi, hapur dhe qartë për herë të parë e pranoi se plani për shkëmbim të territoreve do të hidhet në tavolinën e bisedimeve. Ai tha se nëse pyetet e a do të mund të realizohet vullneti i shprehur politik i shqiptarëve të Luginës, e që është bashkimi me Kosovën



mendën referendumin e vitit 1992, e që në të shqiptarët e asaj pjese kishin vendosur që Luginë e Preshevës të bashkohet me Kosovën, shkruan gazetametro.net.

Presidenti Thaçi, hapur dhe qartë për herë të parë e pranoi se plani për shkëmbim të territoreve do të hidhet në tavolinën e bisedimeve. Ai tha se nëse pyetet e a do të mund të realizohet vullneti i shprehur politik i shqiptarëve të Luginës, e që është bashkimi me Kosovën, kjo është vështirë të thuhet se do të ndodhë, dhe ndoshta e pamundur. Por, presidenti tha se këtë

ide do ta hedh në tavolinë dhe do të diskutohet për të.

Presidenti ndonëse e tha në fund të fjalimit dhe me një gjuhë të kujdesur, përmendja e këtij referendum jep mesazhin e qartë se është hedhur në diskutim shndërimi i territoreve.

"Por sot, u premtoj të gjithë shqiptarëve të Luginës së Preshevës, se Kosova do të përdor çdo mjet legjitim dhe demokratik për të mbrojtur dhe avancuar të drejtat elementare, demokratike e kombëtare të shqiptarëve që jetojnë në Preshevë, Bujanoc e Med-

vegjë, duke përfshirë respektimin e deklaratimit plubishitar të vitit 1992", ishin fjalët e fundit të presidentit Thaçi.

Pas tij edhe ish-kryetari i Preshevës, Ragmi Mustafa, theksoi qëllimin e këtij takimi, ndonëse pa u përmendur konkretisht territori. Mirëpo, ai tha se Luginë është deklaruar në vitin 1992 për këtë çështje.

"Vullneti i popullit të Luginës është shprehur në referendumin e 1992", ka thënë Ragmi Mustafa në konferencën me presidentin Thaçi.

Ndërkohë, edhe dje u raportua

rreth intensifikimit të diskutimeve për shkëmbim të territoreve me Serbinë.

Madje, ky debat u hap edhe në Serbi, ku presidenti Aleksandar Vucic potencoi se do të 'marrin diçka nga Kosova'.

Ndryshe, sipas mediave, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë dritën jeshile për këtë ndryshim terriroresh, si marrëveshje finale që do të siguronte njohjen e Kosovës nga Serbia.

Ndërsa, në anën tjetër, kur kihet parasysh se edhe në Serbi, Vucic politikanët tjerë serbë të linjës së tij, kanë filluar hapur ta promovojnë këtë ide, atëherë Kosova në fund të negociatave pritet të ndahet, duke u shkëmbyer territore.

Këtë mund ta ndalë vetëm bashkësia ndërkombëtare, nga frika se kjo marrëveshje, do të mund të ngjallë ambicinet për ndarje edhe në shtetet tjera të rajonit, si në Bosnje, Maqedoni e Mal të Zi. Pra, me këtë ekziston rreziku që Ballkani të u kthehet luftërave të përgjakshme të viteve 90'të, ku të gjitha u zhvilluan për territore. /gazetametro.net

A PO MBËSHTETET NGA AMERIKANËT NDARJA E KOSOVËS?

Tash askush nuk e di më se çfarë do të ndodhë, nëse preken kufijtë e Kosovës. Çfarë do të ndodhë me Maqedoninë dhe Bosnjën? Ajo çfarë dihet është se Administrata e Donald Trumpit është në një mendje me Rusinë për ndarjen e Kosovës



gjysma e botës. Të gjithë këta kanë qenë, përveç tjerash, në unison të plotë edhe sa i përket kufijve të Kosovës: ata nuk guxojnë të preken, nuk ka ndarje të Kosovës.

Donald Trump, Presidenti jokonvencional amerikan, ekipi i tij, nuk janë dakord me shumëçka çfarë kanë bërë paraardhësit e tij, si brenda ashtu edhe jashtë Amerikës, e sipas të gjitha gjasave as për Kosovën.

Gazeta Express, përmes burimeve të sigurta diplomatike, ka mësuar se Administrata e Donald Trumpit, ata që merren me politikë të jashtme, janë pajtuar që Ko-

sova t'i japë territor Serbisë në këmbim të njohjes së saj.

"Ka mundësi që për këtë çështje ka pasur edhe një bisedë në mes Trumpit dhe Putinit në Helsinik", ka thënë burimi i Gazetës Express, duke shtuar se ky ndryshim radikal në administratën e Donald Trumpit po ndodhë pasi që tash nga aty është larguar ish-këshilltari për siguri kombëtare i Trumpit, H.R. McMaster, dhe pas ardhjes në këtë detyrë të John Boltonit, i njohur për qasjen e tij anti-Kosovë, gjatë kohës kur ka qenë ambasador i SHBA'së në OKB.

"Ka mundësi që do të flitet për

shkëmbim të territoreve. Mirëpo përfundimi i gjithë kësaj drame është se Kosova, ajo çfarë do të mbetet prej saj, do të mund të konsiderohet si një provincë e Shqipërisë", ka thënë ky burim.

Prej kur është shpërbërë Jugosllavia, bashkësia ndërkombëtare vazhdimisht i ka refuzuar idetë për ndarje të territoreve, përtej kufijve që kanë qenë në kuadër të Jugosllavisë. Edhe përkundër një lufte të tmerrshme në Bosnje dhe Hercegovinë, në paqen e arritur në Dejton, palët janë detyruar që të vazhdojnë të jetojnë në një shtet të përbashkët. E njëjta logjikë është ndjekur edhe për Maqedoninë, e edhe për Kroacinë. Përkundër faktit që në këto republika ka pasur pakica etnike, bashkësia ndërkombëtare nuk i ka përkrahur ndarjet. Deri më tash, sa herë është biseduar për ndarje, është thënë që "kjo e hapë Kutinë e Pandorës", metaforë për të këqijat që vijnë pas hapjes së saj, sipas mitologjisë greke.

Tash askush nuk e di më se çfarë do të ndodhë, nëse preken kufijtë e Kosovës. Çfarë do të ndodhë me Maqedoninë dhe Bosnjën? Ajo çfarë dihet është se Administrata e Donald Trumpit është

në një mendje me Rusinë për ndarjen e Kosovës, transmeton Expressi.

Në anën tjetër, Propozimi i Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën mund të përfshijë edhe idenë e ndarjes në vija etnike, duke u munduar kështu të mbajë tokat në të cilat serbët janë shumicë në Kosovë, shkruan agjencia e lajmeve ndërkombëtare Bloomberg.

"Më mirë diçka se asgjë", ka thënë edhe presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq.

Por, një planë i detajshëm se si do të mund të realizohet kjo ndarje ende nuk është parë në publik.

Kjo ndarje nga Serbia po shihet si mundësia që dy vendet të njihen më pas zyrtarisht mes vete dhe kështu të vazhdojnë pa konflikte drejt Bashkimit Europian.

Derisa në Kosovë zyrtarët shtetëror kanë mohuar një opsion të tillë për ndarje të mundshme, as në Serbi nuk është se janë të kënaqur me këtë version për ndarjen.

Kisha Ortodokse Serbe ka kritikuar planin duke thënë se çdo ndarje do të thoshte humbje për Serbinë, pasi Kosova për ta konsiderohet si vendi i shenjtë i Serbëve, transmeton Insajderi

Prishtinë, 26 korrik - Në fund të këtij viti mbushen 26 vjet, saktësisht për Krishtlindje, kur Presidenti George Bush, i vjetri, e kishte kërcënuar Serbinë që të mos niste luftë në Kosovë. Ky njihet si Kërcënim i Krishtlindjeve. Secili president amerikan, pas tij, kur ka qenë në pyetje e ardhmja e Kosovës, ka qenë më i prerë se sa paraardhësi. Të gjithë këta, me angazhimin e tyre, bënë që Kosova në vitin 2008 të shpallë pavarësinë e saj, për t'u njohur më pas nga më shumë se

"Për të mirën e shtetasve tanë, ne do të punojmë se bashku për zero tarifa për mallrat industriale. Do të përforcojmë marrëdhëniet tona edhe në fushën e energjisë," tha Trump

SHMANGET 'LUFTA' TRUMP-BE

ARRIHET MARRËVESHJA PËR TARIFAT TREGTARE



Presidenti i SHBA-së Donald Trump dhe Presidenti i Komisionit Europian Jean-Claude Juncker njoftuan se kanë arritur një marrëveshje për të filluar zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje mbi tarifën dhe për të shmangur një luftë tregtare mes SHBA e BE-së.

"Ne ramë dakord sot para së gjithash për të punuar së bashku drejt zero tarifave, zero barrierat për mallrat dhe makinat jo industriale. Jemi këtu në Shtëpinë e Bardhë për të filluar një fazë të re në marrëdhëniet tona mes SHBA dhe BE, një fazë miqësie të ngushtë për marrëdhënie të forta tregtare, të punojmë me mire bashkë për sigurinë globale. Se bashku ne kemi me shume se 50 përqind të tregut global. Për të mirën e shtetasve tanë, ne do të punojmë se bashku për zero tarifa për mallrat industriale. Do të përforcojmë marrëdhëniet tona edhe në fushën e energjisë," tha Trump në një deklaratë të përbashkët me Juncker në Rose Garden.

Që prej fillimit të këtij viti SHBA ka zbatuar tarifa të larta të aluminit dhe çelikut në Bashkimin Evropian. Blloku u përgjigj me tarifën e njëjtë për mallrat e SHBA.

Trump kishte përshkallëzuar retorikën e tij kundër BE-së në javët e fundit, sidomos duke thënë për CBS News se ai i konsideronte aleatët e vjetër të SHBA si

një 'armik' për shkak të tregtisë. Para vizitës së Juncker në Shtëpinë e Bardhë, Trump kishte ngritur taksat për makinat europiane, duke shtuar më tej shqetësimet se po niste një luftë tregtare globale.

Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të ngrënë tarifa kundër Kanadasë, Meksikës dhe Kinës.

Republikanët dhe demokratët

kanë paralajmëruar se tarifën në fund të fundit dëmtojnë punonjësit amerikanë, por Trump mendon ndryshe.

Marrëveshjen e ka përshëndetur dhe Ministri gjerman i Ekonomisë Peter Altmaier i cili u shpreh entuziast. "Doganat duhen ulur dhe jo ngritur! Kjo siguron tregtinë e lirë dhe miliona vende pune!" shkroi ai në Twitter.



Ligji që zëvendëson gjendjen e jashtëzakonshme në Turqi

Parlamenti i Turqisë miratoi një ligj për sigurinë, që u jep autoriteteve kompetenca të gjera, pasi gjendja e jashtëzakonshme, e vënë pas përpjekjes për puç në korrik të vitit 2016, ka marrë fund javën e kaluar.

Ligji është hartuar nga partia për drejtësi dhe zhvillim e presidentit turk, Recep Tayyip Erdogan, dhe do të jetë i vlefshëm për tre vjet, njoftojnë mediat turke. Ai parasheh mënyra për të shkarkuar gjyqtarë, pjesëtarë të ushtrisë dhe punonjës të ministrive.

Gubernurët e provincave mbajnë disa kompetenca emergjente, të tilla si kufizimi i lirisë së tubimit. Gjendja e jashtëzakonshme, e cila është vënë pak ditë pas përpjekjes për grushtshtet ushtarak më 15 korrik, 2016, përfundoi më 19 korrik, pasi qeveria nuk e zgjati atë.

Opozita e cilësoi ligjin e ri si mënyrë për ta bërë "gjendjen e jashtëzakonshme të përhershme".

Partia e Erdoganit dhe aleatët e saj të ekstremit të djathtë nga partia e Lëvizjes nacionaliste siguruan shumicën parlamentare në zgjedhjet e muajit të kaluar, gjë që u mundësoi atyre të kalonin masën pa probleme.

Shtyhet samiti Trump-Putin

Samiti i dytë mes presidentëve Donald Trump dhe Vladimir Putin nuk do të zhvillohet para 2019, edhe pse presidenti Trump e ka ftuar atë në Shtëpinë e Bardhë në vjeshtë, sepse presidenti ka vendosur t'i shtyjë ato deri në mbylljen e hetimeve të prokurorit special Robert Mueller mbi skandalin Russiagate, theksoi zëdhënësi John Bolton për shtypin.

"Kështu që, është menduar që të takohen në vitin tjetër, pas mbylljes së hetimeve", shtoi Bol-



ton. Polemika të shumta ka në drejtim të presidentit Trump në samitin e Helsinkit, ku gjykohej se Trump është treguar mjaft i

butë me Putinin.

Kritikat u theksuan më shumë kur Trump, si surprizë, ka njoftuar se ka në planin e tij për të ftuar

Putinin në Shtëpinë e Bardhë në vjeshtë. Presidenti amerikan ka pasur kritika edhe nga partia e tij pasi republikanët Paul Ryan dhe Mitch McConnell kanë thënë se Putin nuk do të ishte i mirëpritur në Kongres.

Shtyrja e takimit të dytë vjen edhe pas vendimit të Trump për të thirrur Këshillin e Sigurisë Kombëtare për të folur për sigurinë e zgjedhjeve si dhe deklarata e sekretarit të Shtetit, Mike Pompeo i cili tha se SHBA-të nuk do të njohin Krimenë.

Zjarret që sollën katastrofën, ministri grek gjen fajtorin

Ministri grek i Mbrojtjes Panos Kammenos deklaroi për BBC-në se ndërtime pa leje kishin kontribuar në katastrofën më të rëndë të zjarreve në këtë vend. Kammenos deklaroi se ndërtime e banorëve në mes zonave pyjore ishin një krim që kishin rezultuar në bllokimin e kalimeve. Kammenos u përball me zemërimin e banorëve teksa vizitoi paraditen e kësaj të enjteje zonat e shkatërruara nga zjarri në periferi të Athinës. Kammenos u përball me akuza nga banorët e Matit se qeveria i kishte braktisur ata.

"Na latë vetëm" – i tha një ba-

nor Ministrin të Mbrojtjes i cili shoqërohej në këtë vizitë nga kryetari i Bashkisë dhe Kreu i Forcave Ajrore. Një nga dëshmitarët i tha ministrit se kishte shkuar për të kërkuar ndihmë të një rajon zjarrfikës por punonjësit as nuk e kishin idenë se kishte rënë zjarr. Një tjetër banor u ankua se qytetarët ishin këshilluar të futeshin në det për t'i shpëtuar zjarreve në një kohë që pjesa më e madhe ishin të mosshuar dhe detin nuk e kishin afër.

Ndërkohë, vijon të thellohet bilanci i viktimave nga zjarret e rena në rajonin e Atikës në Athinë. Nga

raportimet e fundit mësohet se numri i të vdekurve ka arritur në shifrën 82. Shërbimet zjarrfikëse janë ato të cilët raportojnë edhe për 187 persona të plagosur. 24 prej viktimave janë fëmijë ndërsa dyshohet për qindra të tjerë të zhdukur.

Prej dy ditësh kryeministri grek, Aleksis Tsipras ka shpallur gjendjen e emergjencës duke kërkuar edhe ndihmë. Thirrjes së Tsiprasit i është përgjigjur Shqipëria dhe shumë vende të tjera i kanë ofruar ndihmë sipas mundësive Greqisë.



Prej 18 deri më 22 korrik 2018, në Komunën e Zhelinës u mbajt Edicioni i Festivalit të Trashëgimisë Kulturore. Ishte ky një manifestim i madh kulturor, i cili u shoqërua me një program të pasur dhe të larmishëm kulturor, letrar, muzikor, humoristik, recitues, sportiv etj. Ai u organizua nga Komuna e Zhelinës dhe Shoqata për Kulturë e Arsim "Adrion", e cila vepron në këtë komunë

Festivali u zhvillua në stadiun e futbollit në Zhelinë. Skena imponante e Festivalit me banderola ishte mbështjellë me një gjysëmrrësh çadrash të Panairit, të mbushur plot me relikte dhe pasuri shpirtërore e materiale të traditës sonë kulturore të 16 fshatrave të Komunës së Zhelinës. Aty ndeshëm një prurje të duartnduart, e cili shenjon vlerat e shumta që plotësojnë sistemin e gjërë të kulturës sonë kombëtare. U demonstuan rite e lojra të ndryshme, këngë e valle të kësaj ane. Në këto çadra qenë ekspozuar vegla pune të bujqësisë, të blegtorisë, të kuzhinës tradicionale...

Festivalin e Trashëgimisë Kulturore e hap kryetari i Komunës së Zelinës, Blerim Sejdiu. Ai theksoi se, ky Festival dhe ky panair paraqesin pasurinë tonë shpirtërore dhe materiale të kombit tonë, i cili është kultivuar brez pas brezi në këtë zonë. Ky festival madhështor është ngritur me qëllim që të afirmojmë kulturën dhe traditën tonë të pasur, si dhe të propagandojmë bukuritë e mëdha natyrore të kësaj komune, të zhvillojë turizmin,

PËRFUNDOI FESTIVALI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË ZHELINË



sportin, etj. Ne, theksoi më tej ai, do të vazhdojmë ta mbështesim edhe në të ardhmen këtë festival të rëndësishëm për traditën tonë kulturore, letrare, muzikore dhe sportive. Festivalin e përshëndeti edhe kryetarja e Shoqatës për Arsim dhe Kulturë "Adrion", Lindita Emërllahu, e cila foli për punën e madhe që u desh të bëhej për të arritur në organizimin e këtij Festivali të parë madhështor në këtë komunë. Ajo beson se, edicioni i rradhës do të jetë edhe më i plotë si rezultat i një përvojë të fituar dhe i një projekti

që sa vjen e formulon portretin e duhur të një Festivali serioz dhe afirmues i të shkuarës sonë të begatë. Gjatë pesë netëve, në skenë, u ngjiten Shoqëri kulturore dhe artistike nga vende të ndryshme të hapësirës shqiptare, këngëtarë të njohur të kësaj zone, rapsodë, këngëtarë, humoristë dhe aktorë; si "Elita 5" me këngëtarin Arif Ziberi, i cili ka origjinën e kësaj zone, këngëtarin Cadaf Elmazi, rapsodi Sevdi Malësia me shokë, Korri i femrave "Nexhmije Pagarusha" – Prishtinë, Grupi i këngëve të vjetra

qytetare "Teuta" – Tetovë, SHKA "Jahi Hasani", Çegran, SHKA "Tingujt e Vendlindjes", Ansambli "AlbaFolk", Qendra kulturore – Kaçanik, Karnavalet Ilire – Bozofcë, valle, këngë, rite, doke, zakone dhe lojra popullore etj.

Gjithashtu, pjesë e Programit të Festivalit ishte edhe video promovuese e bukurisë së Urës shumëshekullore të Zhelinës, me titull "Atdheu duhej më shumë, dikur", pastaj filmi dokumentar "Kohë që duhej të ishin jetë" me skenar dhe regji të profesoreshës,

Lindita Emërllahu, pastaj humoristi i kësaj zone Hasim Memish-Sopi dhe Sami Mustafa, maratona e leximit "Takohemi për një libër" i cili u organizua në fsh. Trebosh të kësaj komune, me emra të njohur të letërsisë dhe poezisë, si Xhelal Zejneli, Bujar Plloshani, Ekrem Ajruli dhe Berzat Sadiki, ekspozita me fotografi të të gjitha fshatrave të kësaj komune të fotografit, Luan Rakipi, debati me intelektualë dhe mërgimtarë etj. Në këtë javë manifestimesh kulturore u zhvilluan edhe aktivitetet sportive si, ndeshje futbollit, basketbolli, çiklizëm, ndeshje e pehlivanëve, ngjitje në këmbë në malet e bukura të Komunës së Zhelinës etj.

Po ashtu, në kuadër të Programit, nxënësit e Shkollës së Muzikës, Biondina Selami, Olti dhe Orel Esati ekzekutuan disa pika muzikore me piano dhe me violinë në manifestime të ndryshme kulturore e letrare. Të gjithë pjesëmarrësit e Programit dhe anëtarët e SHAK "Adrion", të cilët kontribuan në organizimin e Festivalit u vlerësuan me mirënjohje nga Kryetari i Komunës. Festivali u ndoq nga një numër i madh publik, në mesin e të cilëve edhe mjaft kurbetarë që ndodhen për pushime në vendlindje. Kjo festë u shoqërua edhe me një koreografi të bukur fishekzjaresh që shenjonte dimensionin e festës së madhe pesëditore të Edicionit të I-rë, të Festivalit të Trashëgimisë Kulturore. Festivalin e moderuan mjaft bukur dhe me kreativitet, të rinjtë e apasionuar, Narta Emërllahu, Olti Esati dhe Edmond Sadiku. Një festival kulturor e sportiv shumëdimensional i organizuar mjaft mirë nuk është parë më herët në këtë komunë të rurale. Festivali i Trashëgimisë Kulturore, i cili i ka mundur kësaj zone administrative u mbështet materialisht nga Këshilli Komunal i Komunës së Zhelinës me tendencë, që ai në të ardhmen të bëhet tradicional.

"Rrënimi", një tornado letrare nga Leonard Veizi

Mund të konsiderohet dhe si një tornado letrare. Shkrimtari i njohur Leonard Veizi, 3 vjet pas suksesit të romanit "Lora" këtë herë vjen me një roman të ri prej 320 faqesh, të quajtur "Rrënimi".

Ngrehina e një shteti që gërryhet çdo ditë nga korrupsioni, trafiket e paligjshme dhe politikat e mbrapshta. Kjo është në themelin e këtij romani të cilën shtëpia botuese "Buzuku" sapo e ka hedhur në qarkullim.

Karakteret e gdhendura deri në imtësi, egoistë të shfrenuar, prapaska dhe porosi për ekzekutime mafioze. Këto, dhe të tjera më shumë se kaq, na vijnë në faqet e romanit "Rrënimi", në formën e një reviste, ku gjatë shfletimit mund të shohësh si në fotografi të stampuara, të gjithë tranzicionin e shëmtuar që shqiptarët përjetojnë



prej vitesh.

Dhe nëse një ushtarak përpëlitet në zyrën e tij të Ministrisë së Mbrojtjes, pasi ka firmosur marrëveshje të dyshimta që kanë të bëjnë me demontimin e armëve dhe shitjen e tyre, një oficer i shërbimit sekret bën lojë të dyfishtë, dhe një gazetar mundohet të bëjë detyrën duke shpërthyer në faqen e parë skandalin e radhës, kemi

dhe një ekzekutor me pagesë që është i gatshëm të ndërhyjë kudo për të mbyllur gojën e atij që tenton ta hapë.

Nga ana tjetër, pa kërcënime dhe pa armë dhe, një punonjës banke që pas ordinatorit të tij, qarkullon në mënyrë të paligjshme miliona dollarë, duke qenë në këtë mënyrë po aq kriminel sa dhe ekzekutori me pagesë. Dhe në

gjithë këtë ferr mardhënesh ku sundon paraja e pistë, kemi dhe disa histori dashurish, flirte e tradhti imagjinare që e bëjnë romanin në vetvete më atraktiv e të lexueshëm. Romani përfundon tragjikisht me hedhjen në erë të një ndërtesë gjigante ku kriminelët që nuk pyesin për askënd, veç parave të tyre, kërkojnë të mbulojnë gjurmët e një tregtie të madhe armësh. Nga kjo situatë mbeten të vdekur dhe dy persona të tjerë në dy vende të ndryshme. Por për më shumë se kaq duhet lexuar "Rrënimi".

"Personazhet e një shoqërie në tranzicion. Ngarendje drejt parasë, karrierës, ëndrrave e realitetit jo gjithnjë nga ç'ofron zhvillimi i hovshëm. Një gjuhë përmasash epike." Kështu do ta përkufizojë romanin "Rrëfimi", që në kopertinën e tij,

Abdullah Zeneli, presidenti i shtëpisë botuese prestigjioze "Buzuku" me zyrë në Prishtinë.

Ngjarjet në roman janë të mprehta. Ato janë vendosur gjerësisht në territorin shqiptar. Që në fillim autori paralajmëron me frazën e tij se: Çdo ngjashmëri me personazhe, vende dhe ngjarje reale është rastësi. Ndërkohë që të gjitha fenomenet e shkruara në faqet e këtij romani janë produkt i një shoqërie në tranzicion, tipike e shoqërisë shqiptare.

"Rrënimi" është një roman me një mori personazhesh, numri i të cilëve shkon në gati 80. Gjithashtu romani përmban 9 linja, të cilat duket se zhvillohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra, por që pak nga pak lidhen, për t'i çuar ngjarjet drejt një pike të vetme.

(MAPO Letrare)

"LIVERPOOL TV" INTERVISTON XHERDAN SHAQIRIN

PËR MUA FLASIN SHIFRAT, NUK MË INTERESOJNË KRITIKAT

"Sa u përket kritikave të Adam, mendoj se shifrat e mia flasin vetë. Isha shënuesi më i mirë i ekipit, po ashtu lojtari me më shumë asistime", kundërpërgjigjet futbollisti shqiptar

Xherdan Shaqiri mund të kishite shkuar te Liverpooli që para 4 vite-sh, kur Brendan Roxhers tentoi ta blinte, por Bayerni refuzoi prerë. Tani mesfushori shqiptaro-zviceran pret me padurim të debutojë me "The Reds", ndërsa në një intervistë për "Liverpool TV", televizionin e klubit, ka folur gjerë e gjatë për të shkuarën, për kritikën që ka marrë nga vëllezërit Nevil, si dhe për ambiciet e tij. "Bisedova me Brendan Roxhers para Botërorit 2014, më telefonoi dhe isha i interesuar, por Bayerni tha 'jo, të duam këtu, sepse je i rëndësishëm për ne'. Natyrisht, mbeta pak i zhgënjyer, sepse ishte mjaft tërheqëse të luaja në Angli, në një prej stadiumeve më madhështorë në botë", kujton Shaqiri. Për 26-vjeçarën është e qartë çfarë pritet te Liverpooli. "Kam fituar shumë trofe te Bayerni, ndaj e di çdo të thotë të luash në skenën e madhe", shtoi më tej Shaqiri. Ndryshe, karriera e Shaqirit është e



mbushur me klube të mëdhenj: Bazel, Bayern, Inter, derisa erdhi kalimi te Stouk Siti, për të rilindur. Edhe aty ka pasur luhajtje, ka pasur edhe kritika, sidomos nga vëllezërit Geri e Fil Nevil, të cilët tashmë punojnë si opinionistë. Geri Nevil (punon në ITV) e ka quajtur Shaqirin "jo profesionist", ndërsa Fil Nevil (punon për BBC) e ka quajtur një "turp". Edhe një "ish" i Stouk Sitit, Çarli Adam, e akuzoi Shaqirin se

nuk e ndihmoi sa duhej Stouk Sitin sezonin e fundit, që përfundoi në mënyrë dramatike, me rënie nga Premier Liga. Megjithatë, Shaqiri kundërpërgjigjet me qetësi. "Geri dhe Fil Nevil kanë qenë futbollistë të Manchester Junajtids. Ndoshta ata thjesht nuk e kanë qejf Liverpoolin. Nuk e di, disa njerëz të kanë qejf, disa jo. Sa u përket kritikave të Adam, mendoj se shifrat e mia flasin vetë. Isha shënuesi më i mirë i

ekipit, po ashtu lojtari me më shumë asistime", kundërpërgjigjet futbollisti shqiptar. Ndërkohë, Shaqiri bashkohet sërish me Sallah, ku për pak kohë luajti në Bazel. "Është lojtar i shkëlqyer, por do gënjeja nëse do thosha që e prisja këtë ecuri fantastike të tij, kur e takova për herë të parë.

Askush nuk e imagjinonte, uroj që edhe këtë vit të ecë me të njëjtin ritëm", përfundoi Shaqiri

LUFTËTARI KËRKON 100 MIJË EURO Shkëndija këmbëngul për Rrocën

Shkup, 26 korrik - Eduard Rroca i ka munguar shumë Luftëtarit në ndeshjet evropiane. Mesfushori ka kaluar një dëmtim dhe është shumë pranë rikuperimit, ndërkohë që për të ka një interes konkret nga Shkëndija e Tetovës. Drejtuesit e saj duket se e shohin lojtarin e Luftëtarit si zëvendësuesin ideal të Ferhan Hasanit, tashmë i larguar nga Tetova. Sipas "Vipsport.al", kuqezinjët kanë bërë një ofertë për mesfushorin Eduard Rroca në klubin gjirokastrite, por presidenti Tavo ka thënë "Jo". Ai kërkon 100 mijë euro nga Shkëndija për këtë futbollist, si dhe të mbajë një vlerë të caktuar të kartonit. Palët janë ende në bisedime dhe në të ardhmen mund të gjejnë një akord, por të paktën për momentin presidenti Grigor Tavo duket i vendosur për të mos u ulur aspak në kërkesat e tij. Ditët në vazhdim do të tregojnë se çfarë do të ndodhë, nëse Rroca do të qëndrojë në Gjirokastër, apo do t'i bashkohet ekipit tetovar, ku pak ditë më parë kaloi edhe mbrojtësi Gledi Mici. Mesfushori shumë shpejt do të jetë 100 për qindigati, pas një faze rikuperuese që e ka mbajtur larg fushave që para fundit të sezonit të kaluar.



Arbër Zeneli drejt Fiorentinës

Një tjetër shqiptar mund të bëhet pjesë e Serisë A në Itali. Bëhet fjalë për Arbër Zenelin, sulmuesin e Heerenveenit në kampionatin holandez, i cili synohet nga Fiorentina. 23-vjeçari pëlqehet shumë nga drejtuesit e skuadrës vjollcë, që duhet të paguajnë nga 4 deri 5 milionë euro për kartonin e tij. Paratë që duhen për të blerë futbollistin e përfaqësueses së Kosovës ekipi italian pret t'i sigurojë nga shitja e

Ante Rebiç. Sulmuesi kroat më parë ka luajtur për Fiorentinën para se të jepej në formë huazimi te Aindraht Frankfurti e më pas të blihej nga klubi gjerman, por skuadra vjollcë ka ruajtur një përqindje të kartonit (30 për qind). Aindraht mund të përfitojë deri 50 milionë euro nga shitja e kroatit, që do të thotë se në arkat e Fiorentinës mund të shkojnë gati 17 milionë euro.



STRAKOSHA PO RIKUPEROHET NGA DËMTIMI

Jam më mirë, por më mungon fusha



Thomas Strakosha është duke u rikuperuar nga një dëmtim dhe po përgatitet në qendrën stërvitore të Lacios për nisjen e sezonit të ri. Një ditë më parë, portieri i kombëtares shqiptare ka folur për mikrofonin e "laziowews", duke prekur disa tema. "Unë jam më mirë tani, falë Zotit, por më duhet ende kohë për t'u rikuperuar. Më mungon fusha, shpresoj të shërohem së më shpejt", – është shprehur fillimisht shtatlarti i portës së Lacios. Strakosha ka folur dhe për sezonin që lamë pas, duke u shprehur se disfatë ndaj Interit, në ndeshjen e fundit të kampionatit,

tashmë është lënë pas. "Tifozët tanë janë të shumtë këtë vit. Grupi po punon mirë dhe ne jemi më të fortë. Kemi mësuar nga gabimet tona, pasi futbollit ka gjëra të bukura por, dhe të shëmtuara. Hidhërimi mbetet prapa. Ne jemi të rinj dhe gjithmonë duam të tregojmë më të mirën", – është shprehur më tej Strakosha. Për sezonin e ri thotë se duhen përmirësuar gabimet, pasi cilësitë nuk mungojnë, ndërsa konkurrencën në portë nuk e sheh si problem. "Ne duhet të përmirësohemi dhe të mos bëjmë gabimet e së shkuarës. Duhet të jemi të fokusuar

dhe pa u frikësuar nga gabimet. Cilësitë nuk na mungojnë. Proto është duke ecur mirë, ai flet italisht dhe nuk ka nevojë t'ia shpjegojë gjërat. Kjo na ndihmon shumë dhe ai mund të na këshillojë, duke pasur parasysh përvojën që ka. Ekziston një ambient i këndshëm mes portierëve", – ka shtuar portieri kuqez. Më tej, Strakosha ka folur edhe për çështje të tjera, që lidhen me skuadrën, duke u shprehur se largimi i De Vrij nuk do të ndihet në ekip, pasi ka zëvendësues të denjë. Ndërkohë, rritja e kartonit të tij e motivon për të luajtur dhe më shumë.

Ka më shumë se dy javë që u dashtë me shkuar në kontroll, mi bërë analizat në Turqi, por nuk kam mundësi, nuk kam mjete", tha më tutje. "Nuk më duhen më shumë se katër mijë euro për analizë, por Qeveria e Kosovës nuk me ndihmon. Nëse nuk më gjejnë mjete dhe nuk shkojnë në Stamboll për analizë, po me rrezikohet shëndeti, jeta ime", shpreh shqetësimet 'Zizi'

Shkup, 26 korrik - I lodhur deri në pikën e fundit, me një fytyrë jo si zakonisht, i shqetësuar shumë! Ky është legjenda e boksit të Kosovës, Aziz Salihu! Fituesi i medaljes së bronzit olimpikë në vitin 1984 në Los Anxhelos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aktualisht kryetar i klubit të boksit "Prishtina", shpreh brengën e tij sidomos për shëndetin që nuk dukej mirë dhe me një marramendje! "Kam marramendje", tha Salihu për gazetën "Bota sot". "Ka më shumë se dy javë që u dashtë me shkuar në kontroll, mi bërë analizat në Turqi, por nuk

LEGJENDA E BOKSIT NUK KA PARA PËR ANALIZA

SALIHU: QEVERIA NUK MË NDIHMON, JETA IME ËSHTË NË RREZIK



kam mundësi, nuk kam mjete", tha më tutje. "Nuk më duhen më shumë se katër mijë euro për analizë, por Qeveria e Kosovës nuk me ndihmon. Nëse nuk më gjejnë mjete dhe nuk shkojnë në Stamboll për analizë, po me rrezikohet shëndeti, jeta ime", shpreh shqetësimet 'Zizi'. Ka kohë

që Salihu nuk dukej më i rraskapitur, me një shëndet jostabil, ecte çarshisë së Prishtinës, me një shpresë se Qeveria do t'i ndihmojë dhe mos ta lë që të vije në gjendje që sërish të shtrihet në spital dhe të luftojë për jetë! Salihu ka koha që nuk dukej më i plakur nga gajlet e tija, ka ner-

vozizmi dhe ka thellimi në mendime se çfarë mund të ndodhë nëse nuk shkon edhe pak kohë drejt Stambollit, për të bërë analizën! "Nuk jam mirë me shëndet. Më kanë premtuar shumë të tjerë se do të më ndihmojnë, por ende askush nuk me ka qitur mjete", kështu tha Salihu. Në sytë e 'Zizit' vërehej edhe një zhgënjim i madh pothuajse edhe sytë të mbushur me lot! Sillet herë e herë këndej Salihu dhe nuk e kupton përse nuk e ndihmojnë dhe nuk e kupton as vetën sepse bëri aq shumë dhe rrezikoi jetën në kohën e okupimit, duke sfiduar regjimin e Serbisë, kur organizoi edhe garat e pavarura të sporteve luftarake. Siç thotë edhe ai, nëse vdes mos të më vajtojnë edhe as të mburren me veprat e mija, as mos të dalin para masës që të thonë e kemi pasur shok e idhull 'Zizit', kur sot nuk me ndihmojnë siç jam në këtë gjendje të keqe shëndetësore.



Golovin "driblon" Juventusin dhe Monakon

Aleksandër Golovin zgjedh Francën për të vazhduar karrierën. Mesfushori ofensivë që tërhoqi vëmendjen në Kupën e Botës me Rusinë, ishte shndërruar në një prej objektivave të Juventusit, por edhe të Çellsit në merkato, megjithatë ai i befasoi të gjithë. Golovin pritet nga Monako për të kryer vizitat mjekësore dhe të firmosë kontratën me klubin nga Principata. Sipas gazetës franceze "L'Equipe", ylli i CSKA-së së Moskës do të paraqitet sot në Monako, ku do të firmosë kontratën që e lidh me ekipin e ri për 4 vitet në vazhdim. Lajmi është konfirmuar edhe nga e përditshmja ruse, "Sport Express". Me transferimin e Golovin drejt Ligës së Parë franceze, Monako do të derdhë 30 milionë euro në arkat e klubit moskovit. Pikërisht çmimi gjithmonë në rritje i 22-vjeçarit ishte arsyeja përse Juventus u tërhoq nga gara.



Juventusit e sheh Kanten si zëvendësues të Pjaniçit

Skuadra e madhe italiane, Juventusit, e sheh N'Golo Kanten si zëvendësues të boshnjakut Miralem Pjaniç, nëse ky i fundit largohet nga Torino këtë verë. "Zonja e vjetër" është njëra nga skuadrat më aktive në këtë afat kalimtar pasi tashmë kanë siguruar nënshkrime të mëdha si Mattia Perin, Zhoao Kancelo, Emre Xhan dhe Kristiano Ronaldo. Megjithatë, përveç afrimeve në skuadër, drejt-

tuesit e klubit të madh italian duhet të sistemojnë edhe disa largime të mundshme, ku shumë lojtarë të tyre janë të kërkuar në gjithë Evropën. I tillë është edhe mesfushori boshnjak, Pjaniç, i cili po kërkohet nga shumë skuadra të mëdha evropiane, e në veçanti ato angleze. Pjaniç pritet të largohet nga Torino drejt Mançester Sitit pasi kampionët e Ligës Premier dështuan të nënshkruajnë

me Zhorginjon, që u transferua te Çellsit. Sipas mediumit italian "Calciomercato", Juventusit ka bërë mesfushorin e Çellsit, Kante, zgjedhjen e tyre të parë për të zëvendësuar Pjaniçin nëse ky largohet nga Torino. Juventusit tani është duke kërkuar që të luftojë me Paris Sen-Zhermen për Kanten, edhe pse Çellsit thuhet se nuk do të pranonte oferta më të ulëta se 80 milionë euro.

MURINJO FLET PËR TË ARDHMEN E DARMIAN

Largohet vetëm për ofertën e duhur



Hoze Murinjo ka zbuluar se Matteo Darmian dëshiron të largohet nga Mançester Junajtedi, por thotë se klubi nuk do ta shesë mbrojtësin, nëse nuk merr një ofertë të mirë. Anëtori i krahut të djathtë e ndihmoi Mançesterin të enjten, pasi fitoi një penallti kundër AC

Milan, në "International Champions Cup". Megjithatë, ai ka qenë i lidhur ngushtë me një kthim në Itali, mes interesimit të Juventusit, Interit dhe Napolit. Pasi bëri vetëm tetë paraqitje në Premier Ligë, në sezonin 2017-2018, italiani nuk pret që të mbetet në "Old

Trafford" përtej kësaj vere. Por, Murinjo këmbëngul se klubi do të kërkojë një çmim të drejtë për të: "Darmianiu dha shiriti i kapitenit në këtë ndeshje, sepse është një djalë fantastik në dy vitet e mia, por edhe me Van Gaal, para meje. Ai është lloji i djalit, i cili gjithmonë është i gatshëm të japë atë që ka. Ai u rrit te Milani dhe të luante kundër klubit të tij të fëmijërisë si kapiten në një miqësore të tillë kishte një kuptim të mirë. Matteo dëshiron të largohet. Dhe unë mendoj se, kur një lojtar dëshiron të largohet, nëse oferta e drejtë arin, ju duhet të përpiqeni të jeni njerëzor dhe ta lejoni të ndjekë instinktin e tij. Por, deri më tani, ofertat që kemi marrë për Mateon nuk janë as afër pranimit. Pra, nëse Matteo largohet, ai largohet, sepse oferta e duhur vjen. Nëse ai qëndron, mund të jetë i rëndësishëm për ne", deklaroi Murinjo.

Kërkohen 11 vjet burgim për ish-presidentin e Barcelonës



11 vjet burg dhe 59 milionë euro. Ky është dënimi që kërkon Prokuroria e Gjykatës Kombëtare të Spanjës. Ish-presidenti i Barcelonës akuzohet për pastrim parash dhe për organizim kriminal. Dënimi me burg është kërkuar për organizimin kriminal ndërsa dënimi me gjobë për pastrimin e para-

ve të Konfederatës së Futbollit të Brazilit. Kështu prokuroria nuk është ndalur me kaq, por kërkon gjithashtu edhe 7 vjet burg për gruan e Rosell dhe 10 vjet burg më avokatin e tij. Ndërkohë Prokuroria bën me dije se ka që nga viti 2006 që Sandro Rosell e ushtron këtë lloj veprimtarie.

NGA BONUÇI TE HIGUAINI

DHJETË FUTBOLLISTËT E SERIA A QË MUND TË LËVIZIN KËTË VERË

Juventus ka një fitim të madh prej 32 milionë euro për lirim e Pjaniç nga kontrata e tij, të nënshkruar në vitin 2016. Në të vërtetë, ndërsa Pep Guardiola ka insistuar që Mançester Siti nuk është i interesuar për të, Çellsi, Barcelona dhe PSZH janë të gjithë admiruesit e mëdhenj të lojtarit 28-vjeçar



Ndërsa merkatoja e transferimeve të verës në futboll sa vjen dhe nxehtet, ne po ju evidentojmë emrat e mëdhenj të Seria A, që ka mundësi të ndryshojnë klubet para fillimit të sezonit të ri.

GONZALO HIGUAIN

Agjenti i Gonzalo Higuain mund të ishte duke folur për perspektivën e vëllait të tij, duke formuar një partneritet të mrekullueshëm me Kristiano Ronaldo, por, në të vërtetë, ishte e qartë nga momenti që superstari portugez arriti në Torino se ditët e sulmuesit argjentinas te Juventus ishin të numëruara. Çështja e vetme e pazgjidhur është destinacioni i tij i ardhshëm. Një lëvizje për te Çellsi do të kishte kuptim më të madh, duke pasur parasysh se do të ribashkohej me Maurizio Sarri, nën të cilin Higuain e theu rekordin e golave të shënuar në një sezon në Seria A, me Napolin. Megjithatë, edhe Milani është i dëshpëruar për të marrë një golashënues pjellor, pas dështimit me Andre Silva, sezonin e kaluar. Dhe tani, kuqezinjtë duket se janë të gatshëm t'iu japin Leonardo Bonuçi përsëri bardhezinjve, vetëm një vit pasi mbrojtësi u largua nga Juve, si pjesë e një shkëmbimi sensacional të Higuain në Milano.

MIRALEM PJANIÇ

Miralem Pjaniç padyshim është një nga lojtarët më të rëndësishëm të Juventusit, qendër krijuese e mefushës bardhezi, por spekulimet

po rriten, që boshnjaku mund të largohet para mbylljes së merkatos së kësaj vere. Juventus ka një fitim të madh prej 32 milionë euro për lirim e Pjaniç nga kontrata e tij, të nënshkruar në vitin 2016. Në të vërtetë, ndërsa Pep Guardiola ka insistuar që Mançester Siti nuk është i interesuar për të, Çellsi, Barcelona dhe PSZH janë të gjithë admiruesit e mëdhenj të lojtarit 28-vjeçar.

DANIELE RUGANI

Ardhja e Ronaldos në Torino për më shumë se 100 milionë euro do të thotë që Juve tani ka nevojë për një balancim të "librave financiarë", dhe Daniele Rugani është një nga pasuritë më të vlefshme të "zonjës së vjetër". 23-vjeçari kurrë nuk e ka shfaqur egon e nevojshme për ta vendosur veten si një anëtar i rregullt i formacionit juventin, por mbrojtësi është aq elegant dhe i stilit të lartë, sa nuk vihet në dyshim shkëlqimi, nëse ribashkohet me ish-mentorin e tij, Sarri, te Çellsi. Blutë e Londrës janë të "kyçur" në bisedimet me Juventusin për ish-mbrojtësin e Empolit dhe gjithçka mbetet për t'u vendosur është tarifa e transferimit, me kampionët italianë që shtyjnë për 50 milionë euro.

ALEKS SANDRO

Juventus refuzoi të lejojë Aleks Sandron të shkojë te Çellsi verën e kaluar, një vendim që padyshim ndikoi në formën e brazilianit gjatë gjysmës së parë të sezonit 2017-2018. Megjithatë, qëndrimi i "zonjës

së vjetër" tashmë është zbutur, jo më pak për shkak të rikthimit të Leonardo Spinazzola pas një magjie të suksesshme huazimi tek Atalanta. Trajneri Massimiliano Allegri ende do të dëshironte ta mbante Aleks Sandro, por Juventus do të ishte i gatshëm të merrte në konsideratë një ofertë kolosale për 27-vjeçarin e zhdërvjellët, sidomos nëse lojtari nuk nënshkruar një kontratë të re, që skadon për dy sezone.

LEONARDO BONUÇI

Leonardo Bonuçi u bë kapiteni i Milanit vetëm pas largimit të bujshëm nga Juventus, verën e kaluar, por angazhimi i tij ndaj klubit kuqez ka qenë i lëkundur, që nga pika e mesit të atij, që ishte një sezon debutues në "San Siro". Rivendosija e kuqezinjtë në Ligën e Evropës ishte një nxitje për shpresat e tyre, për ta mbajtur në Itali, por duket se gjithnjë e më shumë ka gjasa që ai të lejohet të largohet. Mançester Junajted është një nga klubet e elitës, i interesuar për mbrojtësin, por, siç është përmendur më parë, Milani është joshur nga ideja e përfshirjes së Bonuçi në këmbimin me Higuain, duke i dhënë mundësinë kapitenit të kthehet në klubin e tij të vjetër.

SERGEJ MILINKOVIÇ-SAVIÇ

Sergej Milinković-Savić mbetet një nga çështjet më të nxehta në merkaton e kësaj vere, pas një sezoni bujar 2017-2018 me Lacion. Bardhekaltrit kërkojnë më shumë

se 100 milionë euro për serbin (prezidenti Klaudio Lotito, madje, citohet të kërkojë 150 milionë euro), por Real Madridi, PSZH, Juventus dhe Mançester Junajted janë të gjithë të interesuar për 23-vjeçarin, i cili nuk e ka mbajtur sekret admirimin e tij ndaj Hoze Murinjos.

XHIANLUIGJI DONNARUMMA

Ylli i sagës më dramatike të merkatos së verës së kaluar, Xhianluigji Donnarumma, dhe agjenti i tij, Mino Raiola, kanë mbajtur një profil më të ulët këtë herë, por lëvizja rekord e Alisson nga Roma te Liverpooli mund t'i ndryshojë gjërat në mënyrë të konsiderueshme. Nëse Thibaut Kurtoa largohet nga Çellsi për Real Madridin, shefi i bluve të Londrës, Sarri, mund të shtyjë për ta marrë bashkatdhetarin e tij në "Stamford Bridge".

HOSE KALEHON

Hose Kalehon ka qenë një zbulim, që kur u bashkua me Napoli nga Real Madridi për 10 milionë euro, në vitin 2013, duke formuar një "triumvirat" të mrekullueshëm sulmues me Dries Mertens dhe Lorenzo Insigne. Megjithatë, treshja tani duket e vendosur të ndahet, me trajnerin e ri të "Partenopeit", Karlo Ançelotti, duke favorizuar një formacion 4-3-2-1. Kjo gjë e bën Kalehonin të mendojë për ndonjë klub tjetër. Në moshën 31-vjeçare, spanjulli me siguri nuk dëshiron ta kalojë pjesën më të madhe të sezonit të ardhshëm në stol, prandaj

është i lidhur me një lëvizje larg nga "San Paolo".

DOMENIKO BERARDI

Vendimi i Malkom për të braktisur Romën në minutën e fundit dhe në vend të kësaj të bashkohet me Barcelonën mund të jetë një lajm i mirë për Domenico Berardin. Si një nga yjet e ardhshëm të mëdhenj të Italisë, sulmuesi i Sassuolo është rikthyer gjatë 12 muajve të fundit, me dëmtime që padyshim po i paguan 23-vjeçari. Megjithatë, trajneri i Romës, Eusebio Di Françesko, e lançoi Berardin te Sassuolo, ndërsa drejtori sportiv, Monçi, është gjithashtu një tifoz i madh i një lojtari, që është ende i ri dhe i talentuar sa duhet për të shënuar në nivelin më të lartë.

MAURO IKARDI

Ende duket e pamundur që Mauro Ikardi të largohet nga Interi këtë verë, veçanërisht me zikaltrit në Ligën e Kampionëve për herë të parë në gjashtë vjet. Megjithatë, lëvizja e Ronaldos te Juve i ka ndryshuar gjërat, teksa Real Madridi thuhet se po shqyrton nënshkrimin e Ikardit, edhe si një zëvendësim për "plakjen" e Karim Benzema. Ikardi ka qenë i lidhur me "Los Blancos" disa herë më parë. Edhe pse Interi dëshiron ta lidhë atë me një marrëveshje të re dhe të rrisë klauzolat e blerjes së tij, argjentinas i ndërkombëtar pa dyshim do të kërcejë në mundësinë për të shkuar në Madrid.

DE VRIJ FLET PËR MIKROFONAT E "LA GAZZETTA DELLO SPORT"

INTERI NUK KA FRIKË NGA ASKUSH

Futbolli italian do të përfitojë nga ardhja e një futbollisti të tillë siç është Ronaldo. Serie A do të jetë më tërheqëse jashtë vendit, ndërsa bardhezinjtë më të fortë se kurrë. Personalisht jam i lumtur që gjendem tek Interi dhe ata që përfaqësojnë ngjyrat zikaltër, si dje dhe sot, nuk kanë frikë nga asgjë", shtoi më tej De Vrij



Angazhimet parasezonale nuk kanë asgjë zyrtare, por janë ende të dobishme për të gjetur kohezionin me shokët, veçanërisht në rastin e të sapoardhurve. Një "formulë" e vlefshme për Stefan De Vrij, një nga flamujt e merkatos së Interit kësaj vere, që e mori me parametër zero, pas katër sezonesh të kaluara te Lacio. Parakushtet për një sezon si protagonist janë të gjitha atje, siç u tha nga mbrojtësi holandez për mikrofonat e "La Gazzetta dello Sport". "Këtu tek Interi punohet shumë. Shokët e rinj të skuadrës dhe tifozët më kanë pritur shumë mirë. Cjatë këtyre përgatitjeve jemi përballur me katër skuadra, të gjitha që luajnë në mënyra të ndryshme. Po përgatitemi në mënyrën më të mirë për

sezonin e ri dhe pastaj do të shohim ndeshje pas ndeshje e sa të aftë jemi. Synimi parësor është për të ngushtuar hendekun me skuadrat e tjera, që duken më afër titullit: Juventus, Napoli, Roma. Ky është qëllimi e një klubi ambicioz, si Interi, në këto momente", shprehet mbrojtësi i Interit. Por, a ka frikë nga Juventus i Ronaldos? Mbrojtësi holandez i zikaltërve përgjigjet. "Futbolli italian do të përfitojë nga ardhja e një futbollisti të tillë siç është Ronaldo. Serie A do të jetë më tërheqëse jashtë vendit, ndërsa bardhezinjtë më të fortë se kurrë. Personalisht jam i lumtur që gjendem tek Interi dhe ata që përfaqësojnë ngjyrat zikaltër, si dje dhe sot, nuk kanë frikë nga asgjë", shtoi më tej De Vrij, i cili tregoi se a

e ka pasur të vështirë të zgjedh Interin. "A ishte e vështirë të zgjidhja Interin? Aspak, sepse ndjeva besimin e menaxhmentit zikaltër që nga fillimi. Mu paraqit një program ambicioz, pikërisht ashtu siç jam edhe vetë, ndaj nuk hezitova. Në këtë pikë, zgjedhja ishte e lehtë". Në fund De Vrij foli për bashkëlojtarin e tij në mbrojtje Shkrianiar dhe për faktin se me ata të dy, mbrojtja e Interit do të jetë më e mira e Serie A. "Milan është një lojtar i fortë dhe një person shumë i mirë. Për mua është gjithmonë mirë për të qenë në krah të lojtarëve si Shkrianiar. Është me të vërtetë i ftohtë, gjithmonë bën lëvizjet e duhura. Ai është ende shumë i ri, por ka aq shumë cilësi", përfundoi De Vrij.

DËSHTOI NË BOTËTOR ME BRAZILIN

Nejmar siguron një vend në finalen e pokerit

Nuk ka qenë një Botëtor shumë pozitiv për Nejmarin dhe Brazilin. Pesë herë kampionët e botës, që konsideroheshin favoritët për të triumfuar në Rusi, janë eliminuar në çerekfinale nga Belgjika. Numri dhjetë i "Seleção"-s ka qenë një nga më të kritikuarit, por duket se e ka harruar shumë shpejt zhgënjimin rus. "O'Ney", në fakt, ka pasur sukses në një tjetër fushë të blertë, atë të pokerit. Siç ka bërë të ditur "Bleacher Report", Nejmar ka arritur të sigurojë një vend në finalen e pokerit që po zhvillohet në Sao Paulo. Ai ka qenë një nga nëntë lojtarët, mes 288 pjesëmarrësve, që kanë siguruar një vend në tavolinën finale. Finale që është shtyrë për shkak se sulmuesi duhet të merrte pjesë në një martesë.

PRESIDENTI I FENERBAHÇES
ALI KOÇ ZBULON

Klubi ka 621 milionë euro borxhe

Ali Koç, milioneri turk i cili është bërë kohët e fundit presidenti i ri i Fenerbahçes, ka zbuluar se klubi i tij ka një borxh "modest" të cilin do të mundohet ta shlyejë në vitet në vijim. Sipas tij, gjigantët e futbollit turk kanë për të paguar një borxh prej 621 milionë eurosh. I zgjedhur vetëm pak javë më parë në kreun e klubit, duke mposhtur Aziz Jëlldirim që kishte 20 vite në detyrë, ai pranoi publikisht se situata në klub ishte shumë më e rëndë se 400 milionë euro borxhe që kishte deklaruar paraardhësi i tij. Sipas tij, borxhi arrin shumën 621 milionë euro dhe nëse i shtohen edhe shpenzimet e merkatos së verës dhe afrimet e lojtarëve që janë bërë në këto javë, shifra kalon 700 milionë euro. "Do mundohemi t'i shlyejmë", ishte justifikimi i presidentit të ri, por pjesa më e madhe e detyrimeve janë borxhe ndaj palëve të treta dhe hua afatshkurtra që janë marrë për të shlyer borxhet. Me pak fjalë, klubi i Stambollit është në telashe të mëdha.

LAJME
SHKURT

Reali gati të bëjë çmendurinë për Rodrigon

Bëhet gjithmonë e më konkrete mundësia e kalimit të Rodrigos te Real Madridi. Sipas mediave spanjolle, drejtuesit madrilenë janë gati të përgatisin ofertën për 27-vjeçarin e Valencias. Sulmuesi i kombëtares spanjolle është një prej objektivave të Real Madrid për të zëvendësuar Kristiano Ronaldon, i cili u transferua te Juventus. Gjithsesi për t'ia shkëputur futbollistin ekipit të drejtuar nga Marsejlinjo, "Los Blancos" duhet të paguajnë klauzolën e futbollistit prej 120 milionë eurosh.

Juventus nuk e shet Manxhukin

Borussia Dortmundi tërhiqet nga gara për kartonin e Mario Manxhukin. Lajmi u konfirmua nga shefi ekzekutiv i klubit gjerman, Hans-Joachim Vatzke, i cili mbylli çdo diskutim merkatoje lidhur me sulmuesin kroat të Juventusit. 59-vjeçari deklaroi se Manxhukiq është një lojtar i madh dhe shumë ambicioz dhe për këtë e dëshiron si përforcim në skuadër, por që për fat të keq nuk mund të arrihet. Vatzke deklaroi se bënë maksimumin, por drejtuesit e "zonjës së vjetër" nuk e shesin lojtarin, pasi e konsiderojnë të rëndësishëm për skuadrën.

Roma tani synon N'Zonin

Roma vazhdon të lëvizë me forcë në merkato. Pas goditjes nga Barcelona, që i rrëmbeu në minutat e fundit Malcom dhe sulmit të Kristall Pallas e Everton për Gonalons, verdhekuqtë janë detyruar të ndryshojnë strategjitë në merkato. Në rast të një largimi të Gonalons, drejtori sportiv, Monçi do të synojë Steven N'Zonzi të Sevilyës, i cili ka një klauzolë largimi prej 35 milionë eurosh. Një tjetër alternativë për drejtuesit e klubit nga "Trigoria" është edhe talenti i Lionit, Tanguy Ndombele, që vlerësohet 25 milionë euro.

Tite mbetet seleksionues i Brazilit

Federata Braziliene e Futbollit vazhdon t'i besojë trajnerit Tite, pavarësisht eliminimit të Brazilit që në fazën çerekfinale të Botëtorit "Rusi 2018". 57-vjeçarit i është rinovuar kontrata deri në vitin 2022. Tite e mori drejtimin e Brazilit në vitin 2016, duke pasur në këtë detyrë Karlos Dungen, pas zhgënjimit në "Copa America Centenario". Ai u vlerësua për ekuilibrat që ktheu në skuadër, duke e shndërruar Brazilin në një ekip shumë të fortë për t'u mundur. Humbja 2-1 me Belgjikën në Botëtor, përtej zhgënjimit të tifozët, nuk e ka zbehur vlerësimin për punën e tij, për këtë arsye drejtuesit e federatës i kanë zgatur kontratën.

DASHI 21. mars - 20. prill
Fokusohuni në gjithçka, me qëllim arritjen e një objekti të ri profesional, i cili mund të sjellë një sërë avantazhesh dhe kënaqësish. Megjithatë duhet të tregoheni të durueshëm dhe të shmangni reziqet e kota lidhur me shpenzimet dhe investimet.

DEMI 21. prill - 21. maj
Shmangni tensionet dhe përplasjet e kota me bashkëpunëtorët tuaj. Kjo fundjavë do të jetë e rëndësishme për rigjetjen e sigurisë dhe stabilitetit në dashuri. Duhet të jeni të gatshëm që të pranoni ndonjë kompromis të vogël, vetëm për të kënaqur partnerin/en tuaj.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Kjo e enjte është mjaft e favorshme për të kultivuar dashurinë dhe ndjenjat. Edhe në vendin e punës do të jeni shumë aktiv dhe të përqendruar. Tensione të vogla lidhur me çështjet e punës, mund të zgjidhen lehtësisht.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Nga pikëpamja sentimentale po çoni përpara një rikuperim të ndjeshëm, ndërsa sa i takon profesionit ndjeni nevojën për të gjetur një ekuilibër të ri. Jini të vendosur dhe mos u druani të guxonin më shumë. Në dashuri, duhet të jeni më shumë intuitiv.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Mos e teproni në raport me disa vonesa të vogla në vendin e punës, pasi gjithsesi do të keni një intuitë të mirë, e cila do ju lejojë që të keni bashkëpunime të frytshme dhe të shmangni çdo problematikë.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Kjo e enjte është mjaft interesante për të marrë pjesë në takime të reja për punën, të cilat do ju lejojnë që të merrni stimuj të rëndësishëm për realizimin e një projekti të ri. Sa i takon dashurisë, horoskopi ju fton që të jeni më të kuptueshëm.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Ka disa propozime të rëndësishme, të cilat duhet ti merrni në konsideratë, para se të nisni projekte të reja. Do të shfaqni një sjellje shumë pozitive, dhe mos hezitoni që të shprehni hapur në raport me kolegët tuaj. Puna në ekip do ju ndihmojë të fitoni sfida të reja.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Kjo e enjte është një periudhë mjaft e rëndësishme, për lidhjet në çift. Më në fund do të keni mënyrë që të thelloni disa raporte si dhe të përfshihen në aventura të reja romantike. Në vendin e punës, mos i dekurajoni nga kritikë të tjerëve.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Përfitoni nga kjo fundjavë për të kaluar më shumë kohë cilësore bashkë me familjen dhe partnerin/en tuaj. Në dashuri mos u tregoni shumë të nxituar, por kërkoni vëmendjen e shpirtit tuaj binjak, pasi ky është një moment shumë i favorshëm për emocionet.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Parashikohen ndryshime dhe të reja interesante në vendin tuaj të punës, por duhet të jeni të gatshëm që të pranoni edhe ndonjë kompromis më shumë. Nga pikëpamja emocionale, ky është një moment i mirë për të planifikuar aktivitete të reja në çift. Këshillohet që të jeni sa më romantik.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Sfera emocionale për ju, ka qenë gjithmonë shumë e rëndësishme dhe në këtë moment do të ndiheni mjaft të kënaqur. Keni punuar fortë, ndaj është momenti që të pushoni dhe ti kushtoni më shumë kohë vetes dhe ndjenjave tuaja.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Ka disa konflikte të cilat duhet ti zgjidhni me partnerin/en, lidhur me disa punë që keni lënë në mes. Gjatë kësaj të enjteje, duhet të përpiqeni që të jeni më të hapur për dialog. Propozime të mira, janë fare pranë.



Mensur Mamuti	VEPËR E POETIT NË FOTO, "... HAJDUT"	MINIMUMI I NEVOJITUR JANËTAREVE TË NJË KUVENDI	AKTOR DHE REGJISOR AMERIKAN	PJESORE MOHUESE	ENË E MADHE BAKRI (SH. PASHQI) RRALLËSI (GREQ)	K	GRUPI ANGLEZ, ... PËRPËLL NIKELI	SHTRESA E TOKËS SILIC-ALUMINË
MBRAPA, PAS E KUNDËRTA E PRAKTIKËS								
T								
VEPËR E POETIT NË FOTO JO USHTARAK								
C								
BANORI I QYTETIT TË LINDJES SË POETIT NË FOTO							SHKO	
EMRI I PËRBASHKËT I EVROPEËS DHE AZISE							POHIM PROVERB RITMIK I SHKURTË (SH)	
PJESË E NJË MODELJI PËR PROVE							NDAJFOLJE, PREJ	
FILMI I KOSTA GAVRASIT (Z)							AUTORI AMERIKAN I STRIPAVE, LI	
Z				NIERI (ARAB.)				TEMPERATURA KARAKTERISTIKË E MOSHËS SË RINISË
KOHA	BASHKIM						KËNGËTARJA, RITA	
	SHTET NË AZI						NOVITET	
QË KA IMUNITET						FUTBOLLISTI YNË, LENJANI		
						NJË LIDHEZ		
REOMIRI BAST		ESTONEZI						
		TRAJTË E SHKURTË E PËRËMIRAVE ATA, ATO.						
K				AJNSHTAJNIMI			MALLI I GRUMBULLUAR NË MAGAZINË	
				ENERGJIA			RUMANIA	
SHTORE KASETASH								RADIUMI

ZGJIDHJET: MBAS, TEORI, RUSHA, CIVIL, K, DIP, SHKODRANI, IK, EUROAZIA, PO, MOSTRA, NGAS, ZORO, INSAN, T, UNITET, ORA, IMUNE, ERMIR, R, ESTONIANI, KAULI, ES, STOK, KASETERI, RA.


Sudoku

shumë i lehtë
shumë i vështirë

					6	4		1	1			4					9
9					3			7			7		1				
	7											8		3			4
		5									2	5			6		3
	1		8					2		1						8	
4						8	3		8		4			9	5		
			2	3	9			6				1		2			
					5	1							6		4		
7		8	6					9	9					8			5

Shumë i lehtë: 283976451, 964513287, 571428963, 895237614, 316894572, 427165839, 152389746, 649751328, 738642195. Shumë i vështirë: 153427869, 487916352, 269853174, 792581643, 615234987, 834679521, 548192736, 321765498, 976348215.

Zbulimi i madh, gjendet një "liqen" me ujë në Mars



Një 'liqen' me ujë të lëngshëm besohet se është gjetur në planetin Mars. Lajmin e kanë bërë të ditur shkencëtarët e NASA. Sipas tyre liqeni është gjetur 20 kilometra nga poli i jugut në Planetin e kuq. Studimet e mëparshme gjetën shenja të mundshme të ujit të rrjedhshëm në sipërfaqen marsiane, por kjo është shenja e parë e një trupi që besohet se ka ujë të vazhdueshëm. Shtretërit e liqenit si ato të eksploruara nga sonda e NASA-s tregojnë se në të kaluarën, uji ka qenë i pranishëm në sipërfaqen e Marsit. Megjithatë, klima e planetit është ftohur për shkak të atmosferës së tij të hollë, duke bërë që shumica e ujit të ngrijë. Zbulimi është bërë duke përdorur 'Marsis', një instrument radari në orbitën e Marsit.

'Ndoshta nuk është një liqen shumë i madh', thotë profesori Roberto Orosei nga Instituti Kombëtar Italian i Astrofizikës, i cili udhëhoqi edhe studimin. Marsis nuk ishte në gjendje të përcaktojë se sa thellë mund të jetë shtresa e ujit, por ekipi i studiuesve vlerëson se është të paktën 1 metër. Kjo me të vërtetë e kualifikon këtë vend si një burim uji. Nuk bëhet fjalë për një liqen si në Tokë, që mbush një hapësirë mes shkëmbit dhe akullit', shtoi Prof Orosei. (BBC)

nga Instituti Kombëtar Italian i Astrofizikës, i cili udhëhoqi edhe studimin. Marsis nuk ishte në gjendje të përcaktojë se sa thellë mund të jetë shtresa e ujit, por ekipi i studiuesve vlerëson se është të paktën 1 metër. Kjo me të vërtetë e kualifikon këtë vend si një burim uji. Nuk bëhet fjalë për një liqen si në Tokë, që mbush një hapësirë mes shkëmbit dhe akullit', shtoi Prof Orosei. (BBC)



Kina ndërton ujëvarën më të lartë në botë mbi një kullë 108 metra

Kina ka ndërtuar ujëvarën më të gjatë, e bërë nga dora e njeriut dhe jo nga natyra. Dhe e veçanta e saj është pasi ajo është ndërtuar në një ndërtesë në lartësinë 108 metra. Ujëvara gjendet në qytetin Guizhiou në Kinë dhe uji bie nga njëri kat i ndërtesës dhe pamja është mahnitëse. Ndërsa uji nuk rrjedh vazhdimisht, por lëshohet vetëm në raste speciale dhe për vetëm 20 minuta, duke ofruar kështu pamje spektakolare.

Si e paralajmëroi vdekjen kuzhinieri që u dogj bashkë me gruan dhe 2 fëmijët

Panos Kokkinidis ishte një shef kuzhine, i cili bashkë me gruan e tij dhe dy fëmijët humbën jetën nga zjarret në zonën e Matit në Athinë. "Nëse një mrekulli nuk do të ndodhë, ajo do të djegë shumë njerëz", shkroi për fat të keq Panagiotis Kokkinidis në profilin e tij në Facebook, pak orë para se ai të vdiste. Ndërsa publikoi edhe një video teksa zjarrit digjte zonën dhe kishte marrë përmasa të mëdha.

shkroi për fat të keq Panagiotis Kokkinidis në profilin e tij në Facebook, pak orë para se ai të vdiste. Ndërsa publikoi edhe një video teksa zjarrit digjte zonën dhe kishte marrë përmasa të mëdha.



Shekulli III-na ishte një herë libri me shkrim dore

Kemi shkruar që shkrimi u shpik nga kinëzët, 5500 vjet më parë. Kemi thënë edhe që libri i parë shtypur me letër në një tipografi, u shpik nga arabët 1000 vjet më parë. Por, s'kemi thënë një etapë të rëndësishme të historisë së librit: Shkrimin e tij me shkrim dore.

Kështu, formën e parë të një libri të vërtetë, e hasim në shek. III. Dhe si gjithmonë më parë, nga religjionet. Librat shfaqen për herë të parë në manastire, në periudhën e Mesjetës, rreth shek. III. Kur punësoheshin njerëz të dhënë pas studimeve për të kopjuar dokumente të konsideruara të rëndësishme. Murgjit e manastireve ishin si të punësuar profesionistë, që veç shkrimeve liturgjike i kushtonin kohë edhe kopjimit dhe shpëtitimit të librave klasikë të antikitetit. Për shkak të orëve të gjata të shkrimit,



ata njihen si kodikë, libra të shkruar me dorë, të përbëra nga fletore të palosura dhe të qepura. Dhe sigurisht, me një kaligrafi mjaft të pastër.



KALENDARI HISTORIK 27 KORRIK

- 1230 – Traktati i San Germanos mes Perandorit Frederiku II dhe Papa Gregori IX
- 1298 - Alberti I, biri i Rudolfit të Habsburgëve, kurorëzohet mbret i Perandorisë Së Shenjtë Romake.
- 1549 – Anija e priftit jezuit Fransis Ksavier arrin në Japoni.
- 1586 - Sir Walter Raleigh sjell duhanin e parë në Angli nga Virxhinia.
- 1655 – Holanda dhe Branderbugu nënshkruajnë marrëveshje ushtarake.
- 1713 – Rusia dhe Turqia nënshkruajnë traktat të paqes.
- 1789 – Kongresi amerikan themelon Departamentin për punë të jashtme (Departamentin e Shtetit)
- 1794 – Rënia e Robespierit në Paris.
- 1795 – Spanja dhe Franca nënshkruajnë traktat të paqes.
- 1809 – Beteja e Talaverës: Armata britanike dhe spanjolle kundër armatës franceze.
- 1941 – Ushtria gjermane futet në Ukrainë.
- 1941 – Forcat japoneze zbarkojnë në Indo-Kinë.
- 1962 – Martin Luther King Jr arrestohet në Albeni Xhorxhi
- 1990 – Bjellorusia shpall pavarësinë.



A E DINI SE...

Një njeri harxhon mesatarisht 3 vjet të jetës në banjë.



Në krahun e një majmuni ka rreth 25 milionë qime.



Mjalti mund të qëndrojë pa u prishur 3000 vjet dhe për këtë arsye dylli i mjaltit përdoret për procesin e mumjazitimit.



BARSOLETA

1- Pse matematicienet kane frike te ngasin makinën.
-Sepse gjeresia e rruges eshte e paperfillshme ne krahasim me gjatesine e saj.

2 - Perse kur nje bjonde u hodh me parachute nuk e hapi parachuten ??
Se ishte dit me diell dhe nuk bien-te shi !



THËNIA E DITËS



"Sikur ta kishte mbrojtur Skënderbeu Konstantinopolin, turqit nuk do të kishin mundur ta merrnin në maj 1453". Voltaire, (Volter) François-Marie Arouet, shkrimtar francez